Projekti Pilot 1 Përmirësimi i zbrazjes dhe sistemi grumbullues në zonën rurale	1. Për të përmirësuar cilësinë e grumbullimit të mbetjeve duke ofruar shërbimin e grumbullimit në datë dhe në kohë të përcaktuar.	1·1. Për të matur kohën e fillimit, fundin e shërbimit të grumbullimit, si dhe kohën e grumbulluar në çdo pikë duke e monitoruar. 1·2. Shkalla e kënaqësisë së banorëve nga vëzhgimi i intervistave publike.	1. Është e rëndësishme mirëmbajtja periodike e mjetit të grumbullimit, pasi banorët mund të mos bashkëpunojnë në sistemin e grumbullimit të mbetjeve nëse sistemi i grumbullimit do të ishte jo i qëndrueshëm, si rezultat i prishjes së mjetit. 2. Për grumbullimin derë më derë, marrdhënia ndërmjet ekipit të grumbullimit dhe banorëve duhet të jetë më e fortë në krahasim me grumbulluesit e mëparshëm të kontenierëve. Prandaj ekipi i grumbullimit duhet të ofrojë një shërbim publik të rregullt që të rritet shkalla e kënaqësisë së banorëve.	1. Bashkia që gjendet në zonën e fermës duhet të mbulojë shtrirje të gjerë të shërbimit të grumbullimit sepse është e vë shtirë të vendosësh kontenier duke marrë parasysh të gjitha familjet. Megjithatë, grumbullimi derë më derë është efektiv në përmirësimin e mënyrës së zbrazjes, cilësinë e shërbimit të grumbullimit dhe parandalimin e zbrazjes së mbetjeve, sepse grumbullimi derë më derë me muzike ofron shërbim grumbullimi meqënëse shtëpitë në atë zonë nuk mungojnë në shumicën e rasteve. 2. Megjithatë, është e domosdoshme për shërbimin e grumbullimit të pyesi çdo familje për mirëkuptim dhe bashkëpunim pasi është e rëndësishme të zhvillojnë fushatë sensibilizuese përpara fillimit si dhe gjatë ecurisë së punës. Ai gjithashtu kërkon një sasi të caktuar shpenzimesh. 3. Duhet përgatitur një sistem i duhur menaxhimi për mjetin e grumbullimit për të ofruar shërbim të planifikuar grumbullimi.
Përmirësimi i zbrazjes/grumbullimit të mbetjeve bashkiake në zonën rurale në përgatitje për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të ricikluesshme,	2. Përmirësimi i mënyrës së përshtatshme të zbrazjes sipas rregullave të zbrazjes.	2. Të numërohet numri i qeseve të zbrazura nëse është e përshtatshme duke i monitoruar.		
	3. Situata e zbrazjes së mbetjeve do të përmirësohet.	3·1. Vëzhgimi i situatës së ish vendeve të zbrazjes me beton për të identifikuar zbrazje të papërshtatshme duke i monitoruar. 3·2. Shkalla e kënaqësisë së banorëve për përmirësimin e zbrazjes së mbetjeve nga intervistat publike.		
Projekti Pilot 2 Grumbullimi i ndarë i mbetjeve të ricikluesshme	1. Të promovojmë për banorët që të jenë të vetëdijshëm në pakësimin dhe riciklimin e mbetjeve.	1·1. Të matet pesha e të ricikluesshmeve të mbledhura në çdo kategori duke e monitoruar. 1·2. Të vëzhgohet ndryshimi i mendimit mbi pakësimin dhe riciklimin dhe shkalla e bashkëpunimit për PP nga intervista publike.	1. Duhet kuptuar që ai kërkon një shpenzim të caktuar. 2. Merret në konsideratë rruga e kursimit për koston e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve të ricikluesshme përmes këtyre konsideratave si shpeshtia e grumbullimit, mënyra e depozitimit të ricikluesshmeve të grumbulluara dhe bashkëpunimi me mbledhësit e mbetjeve, megjithatë kjo mund të jetë shoqërisht e diskutueshme. 3. Sistemi i grumbullimit të ndarë të ricikluesshmeve do të kontribojë në reduktimin e impakteve negative mjedisore dhe në koston e transportit të mbetjeve të grumbulluara për në landfill në të ardhmen. Mbi këto baza, bashkia duhet të vendosë plotësisht dhe të bindë banorët për rëndësinë e grumbullimit të ricikluesshmeve.	1. Të gjitha bashkitë kanë probleme të përbashkëta që është mungesa e një venddepozitimi të përshtatshëm dhe venddepozitimi egzistues ka ndikim të dëmshëm në mjedis kështu që PP mundësojnë ndihmë për zgjidhjen e tij. Gjithashtu grumbullimi i ndarë është efikas në rritjen e ndërgjegjësimit për përmirësimin e mjedisit sepse zbatohet i bazuar në bashkëpunimin e banorëve mbi fazën e zbrazjes. Veçanërisht, grumbullimi i ndarë i të ricikluesshmeve me sistemin e grumbullimit me zile i shfaqur në PP është efikas në aspektin e mbajtjes së banorëve të ndërgjegjshëm dhe të interesuar. 2. Megjithatë, grumbullimi i ndarë për të ricikluesshmet kërkon shumë përpjekje dhe kosto të bashkisë. Bazuar në këtë mirëkuptim, rekomandohet të konsiderohen rezultatet e zbatimeve të PP në Cërrik. 3. Në bashkinë, që për momentin nuk është në gjendje për të kryer në mënyrë të përshtatshme menaxhimin e mbetjeve, ajo duhet të prezantojë zbrazjen & grumbullimin e përmirësuar para fillimit të sistemit të grumbullimit të ndarë të ricikluesshmeve siç është bërë në disa pjesë në zonën e bashkisë Cërrik sipas PP1.
Zbatimi i grumbullimit të ndarë i mbetjeve të ricikluesshme në të gjithë zonën e ish bashkisë Cërrik për të pakësuar shumën e mbetjeve që duhen asgjesuar	2. Të kuptohet nga banorët menaxhimi i mbetjeve bashkiake nëpërmjet aksionit që kontribon në përmirësimin e mjedisit.	2. Të informohen banorët për rezultatet e PP si sasia e të ricikluesshmeve të grumbulluara dhe përfitimet nga shitja e tyre.		
	3. Është e mundur që të pakesojmë sasinë e mbetjeve që grumbullohet dhe cohet në venddepozitim.	3. Të matet pesha e të ricikluesshmeve të grumbulluara në çdo kategori duke e monitoruar.		
	4. Kjo ndihmon në përmirësimin e situatës së venddepozitimit.	4. Të matet pesha e të ricikluesshmeve të grumbulluara në çdo kategori duke e monitoruar.		

C.3 Matrica e vlerësimit për projektin pilot në bashkinë Tiranë

Bashkia Tiranë

Skica e Projektit Pilot	Rezultatet e pritshme	Treguesi i vlerësimit	Qëndrueshmëria nga NjQV (Supozimi në Mars 2016)	Mundësia për të aplikuar në NjQV të tjera (Supozimi në Mars 2016)
Faza I Aktiviteti riciklues i shkollave si një afrim për komunitetin përreth	1. Ndër mbetjet e krijuara në shkolla si, shishet PET, kanaçet e aluminit, dhe shishet e vogla të lë ngjeve, të zbrazura në kontenierët e bashkisë do të pakësohet.	1. Sasia e shisheve PET, kanaçet e aluminit, dhe shishet e synuara të qelqit t ë zbrazura për riciklim nga shkollat. (Dosja e sasisë së ndarë e mbajtur nga shkollat).	1. Projekti do të kryejë monitorimin e tregëtisë ndërmjet ricikluesve dhe shkollave, por ajo do të jetë e nevojshme për zhvillimin e sistemit të monitorimit nga bashkia ose nga vetë shkolla. 2. Edhe brenda zonës administrative të Tiranës, mbetjet e ricikluesshme të cilat janë marrë nga riciklues aktivë në zona të ndryshme mund të ndryshojë. Prandaj është e nevojshme që të përputhen mbetjet e ndara në shkollë me mbetjet që merren nga ricikluesit në lagjen e shkollës në mënyrë që të shmangen përpjekjet e kota të studentëve (studentët mund të dekurajohen ose humbin pritshmëritë për riciklimin nëse të ricikluesshmet e grumbulluara nuk do të riciklohen). 3. Bashkia nuk ka një buxhet të veçantë p ër ndërgjegjësimin dhe kompanitë grumbulluese të kontraktuara priten të kryejnë program ndërgjegjësimi në bazë të kontratës së tyre gjithpërfshirëse. Prandaj sistemi për të kryer ndërgjegjësimin kur fillon të njëjtin program duhet të jetë në vend.	1. Kjo është e vlefshme për të bërë **qytetarët të njohin** qëllimin e **"3R" nga pikë pamja e menaxhimit të mbetjeve të ngurta**. 2. Mbetje të tilla të ricikluesshme që kanë vetëm treg të kufizuar ose kanale të kufizuara tregëtie brenda Shqipërisë kërkojn ë zhvillimin e një sistemi grumbullimi i cili mundëson për të grumbulluar sasi të mjaftueshme të të ricikluesshmeve ose ndë rhyrje të tilla si krijimin e një tregu të ri ose promovimin e një industrie për të ricikluesshme të tilla, dhe mund të paraqesin kufizime në promovimin e aktiviteteve ricikluese. 3. Në qytetet e mëdha, ku fabrika të ndryshme riciklimi janë në dispozicion dhe shumë riciklues mund të gjenden aktivë, ky tip aktiviteti riciklues mund të implementohet nëse mbetjet e synuara përputhen me të ricikluesshmet që merren në tregjet e tyre. 4. Në NjQV me madhësi të vogël, ku disponibiliteti i ricikluesve të ndyshëm pritet t ë jetë i njëjtë në të gjithë NjQV (ose brenda zonës së një njësie administrative akoma edhe më të vogël nën një NjQV), ka një mundësi më të lartë për të implementuar një sistem të uniformizuar në të gjithë zonën.
	2. Studentët do të kuptojnë sasinë e mbetjeve të zbrazur nga shkolla e tyre dhe do njohin efektin e zbrazjes së ndarë të të ricikluesshmeve nëpërmjet	2. Shkalla e përmirësimit në ndërgjegjë simin e studentëve kundrejt zbrazjes së ndarë të të ricikluesshmeve. (nga pyetësor ë)		
	3. Eksperienca e studentëve në zbrazjen e ndarë të të ricikluesshmeve do tu komunikohet familjeve të tyre dhe komunitetit më rreth shkollave.	3. Prindërit e studentëve të shkollave të synuara do njohin aktivitetin e riciklimit që po kryhet nëpër shkolla. (Pyetësorë prind ërve)		
Faza 2 Zgjerimi i zbrazjes s ë ndarë & grumbullimi i të ricikluesshmeve në komunitetet përreth shkollave të synuara.	1. Banorët do kuptojnë rëndësinë dhe rregullat e zbrazjes së ndarë të të ricikluesshmeve.	1. Rezultati i pyetësorit për banorët e komunitetit të synuar.		
	2. Sasia e të ricikluesshmeve të zbrazura në kontenierët bashkiakë në zonën e Laprakës do të pakë sohet në një sasi të caktuar.	2-1) Sasia e të ricikluesshmeve të ndara të zbrazura nga komuniteti do të rritet. 2-2) Proporcioni i të ricikluesshmeve të përfshira në mbetjet e zbrazura nga grumbullimi i më rgjithshëm i mbetjeve të komunitetit do të ulet. (Rezultati i VSPM në komunitetin e synuar për tu krahasuar me rezultatin e VSPM 2014)		
	3. Zonat rreth kontenierëve bashkiakë të vendosur në Laprakë do të mbahet e pastër.	3. Rezultati i pyetësorit për banorët e komunitetit të synuar.		

D Diskutim

Seminari u kryesua nga Z. Redi Baduni, Drejtor i Mjedisit në Ministrinë e Mjedisit, dhe u lehtësua nga Znj. Nishi e ekipit të Projektit.

Z. Baduni mbajti fjalën e hapjes së seminarit të dytë mbi Udhëzuesin 3R në Republikën e Shqipërisë. Gjatë kohës që Projekti ka filluar, Ministria e Mjedisit ka pasur mundësinë të vlerësojë objektivat që janë parashikuar për tu përmbushur, të vendosë kontakte me strukturat e njësive vendore të cilat kanë një rol të caktuar, jo vetëm me ato të parashikuara në Projekt, por të evidentojë cila zonë mund të jetë zona model sipas standarteve të Shqipërisë, dhe të evidentohet se cili është problemi në Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve të Ngurta.

Një nga problemet në vendin tonë është moszbatimi i strategjisë kombëtare të mbetjeve. Akti ligjor i cili u jep mundësinë NjQV-ve për të kryer më mirë çështjen e ndarjes së mbetjeve është duke mundësuar ngritjen e infrastrukturës për ndarjen e mbetjeve në mënyrë praktike. Gjithashtu ne do zgjojmë një interes për blerësit vendas për të filluar çështjen e riciklimit sepse dihet që pjesa e mbetjeve zë edhe një interes ekonomik.

Gjithashtu Z. Baduni u shpreh se bashkëpunimi me JICA ka qenë një bashkëpunim shumë pozitiv i cili ka filluar në vitin 2014. Projekti JICA i atashuar me tre qytete, ish komuna Bushat që tani është brenda bashkisë Vau i Dejës, bashkia Cërrik dhe bashkia Tiranë. Njëkohësisht, përveç këtyre tre bashkive që janë të përcaktuara në projekt, JICA ka bërë një monitorim më të gjerë të bashkive të ndryshme të Shqipërisë. Sot, jemi mbledhur për të vëzhguar draft udhëzuesin 3R.

Më pas ai ia kaloi fjalën Këshilltarit Kryesor të Projektit, Z. Hiroshi Fujita.

Z. Fujita shpjegoi tre objektivat e seminarit si më poshtë. Objektivat janë 1) për të prezantuar skicën e draft Udhërrëfyesit 3R, 2) për të familjarizuar bashkitë pjesëmarrëse me metodat e përzgjedhjes së aktiviteteve 3R, dhe 3) për të prezantuar projektet pilot 3R që janë duke u zbatuar nga Projekti.

Pastaj, ai vazhdoi shpjegimin e draft Udhërrëfyesit 3R dhe politikat kombëtare bazë për 3R e mbetjeve.

Prezantimi tjetër u morr nga Z. Koji Kusunoki, i cili shpjegoi përzgjedhjen e aktiviteteve 3R të realizueshme në Shqipëri, përgatitjen e Plani Veprimit 3R dhe aktivitetet 3R të përzgjedhura në NjQV-të model.

Gjatë shpjegimit të të dhënave të njësisë së prodhimit të mbetjeve në çdo kategori në NjQV-të, pati një pyetje nga përfaqësuesja e Bashkisë Sarandë (Q.1).

Pas përgjigjes së Q.1, Z. Kusunoki prezantoi Software-in e krijuar nga Projekti për formulimin e rrymës së mbetjeve dhe shpjegoi funksionin e tij. Pas shpjegimit, pati pyetje nga disa përfaqësues nga bashki të ndryshme (Q.2) dhe Z. Kusunoki u përgjigj.

Pas përfundimit të Z. Kusunoki, lehtësuesi propozoi kthimin tek pyetja për numrin e 373 g/frymë/ditë për bashkinë Tiranë, Z. Oda iu bashkua panelit për të argumentuar përgjigjen e pyetjes.

Z. Polikron Horeshka, përfaqësues nga Ministria e Mjedisit u shpreh se për banorët e Tiranës shifra e mbetjeve gr/frymë/ditë varion nga 0.7-1.1 kg për arsye se vlera ndryshon nga muaji në muaj dhe duhet bërë vëzhgimi gjatë gjithë vitit pasi në muaj të ndryshëm, njerëzit konsumojnë në sasi të ndryshme.

Ndërkohë që Z. Oda po bënte gati grafikun për të shpjeguar sasinë e mbetjeve gr/frymë/ditë, Z. Bajraktari, asistent i projektit, shtoi se bazuar në eksperiencën e tij për projektin e

mësipërm i cili ka kryer studimet në Tiranë tha se vlera e prezantuar mund të konsiderohet e saktë pasi janë bërë shumë matje dhe studime për nxjerrjen e asaj vlere.

Një pyetje tjetër nga pjesëmarrësit ishte nëse bashkia do të ishte e aftë për të bërë planin vendor të menaxhimit të mbetjeve në përfundimin e projektit me të dhënat e nxjerra nga JICA,

Z. Kusunoki u shpreh se rryma e mbetjeve të bashkisë përbëhet nga sasia e të ricikluesshmeve dhe sasia e depozituar, të gjitha në total dhe se për familjet vëzhgimi është bërë i imtësishëm ndërsa për bizneset nuk është vëzhguar me imtësi përbërja e mbetjeve, por e rëndësishme është që të bëhen vëzhgime që të kemi rezultate sa më të sakta të mbetjeve që prodhohen.

Pas një pushimi të shkurtër, Z. Oda shpjegoi me grafik sasinë e mbetjeve gr/frymë/ditë për bashkinë Tiranë duke bërë krahasimin ndërmjet mbetjeve të grumbulluara në landfill gjatë gjithë vitit, e marrë nga viti 2009-2014 dhe numrin e popullsisë në vitet përkatëse.

Z. Horeshka shtoi se llogaritjet duhen bërë në bazë të popullsisë që jeton aktualisht pasi normativa do dilte më e lartë dhe se matja në landfill është në total dhe jo e ndarë, për këtë arsye koefiçienti është i ulët.

Z. Oda u shpreh se e vlerësonte mendimin por ishte e vështirë gjetja e saktë e numrit të banorëve dhe se ky grafik ishte bërë prej tyre sipas të dhënave të tyre. Ai gjithashtu kërkoi sygjerime për të patur një rezultat sa më të saktë.

Në vazhdimësi, përfaqësuesi nga qyteti i Kuçovës shtoi se për bazë duhet marrë numri i popullsisë i dhënë nga zyrtarët e bashkisë pasi në qytetin e Kuçovës, sipas gjëndjes civile janë 30244 banorë, sipas censusit të vitit 2011 janë 16800 banorë ndërsa bashkia Kuçovë di që atje jetojnë 20000-21000 banorë dhe se mbi këtë numër duhen bërë llogaritjet.

Lehtësuesi propozoi se pyetjet e tjera mund ti linin për në fund dhe të vazhdonin me prezantimin e projekteve pilot me përfaqësues nga secila bashki.

Prezantimi i rradhës ishte nga Z. Zija Gerbeti, përfaqësues nga bashkia Vau i Dejës. Z. Gerbeti iu rikthye pjesës së mbetjeve gr/frymë/ditë dhe u shpreh se rezultatet nga JICA ishin shumë të sakta pasi për zonën e Bushatit, përpara se JICA të bënte llogaritjet, ai i kishte llogaritur vetë duke ditur numrin ekzakt të banorëve dhe shifrat e nxjerra prej tij dhe shifrat e nxjerra nga JICA ishin të njëjta. Z. Gerbeti bëri edhe shpjegimin e projektit pilot për Bushatin deri në fazën e arritur deri më tani, ndryshimet e ndodhura në lidhje me mbetjet dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme të zonës.

Pas tij, përfaqësuesi i bashkisë Tiranë, Z. Sadik Cana shpjegoi projektin pilot për bashkinë Tiranë. Znj. Nishi shtoi se të gjitha materialet janë gati dhe pritet që të fillojë zbatimi ditët në vazhdim.

Në vazhdimësi, Z. Qerim Baku nga bashkia Cërrik shpjegoi ecurinë e projektit pilot në bashkinë e tij dhe përmirësimin e situatës.

Me perfundimin e tij, Z. Horeshka ndërhyri duke u shprehur se nuk është bërë ndarja e mbetjeve që në burim dhe nuk janë parë kërkesat e legjislacionit.

Z. Gerbeti u përgjigj se janë në fazat e para të projektit pilot dhe se në muajt e ardhshëm do bëhet edhe ndarja e mbetjeve që në burim.

Znj. Nishi gjithashtu u përgjigj duke thënë se Projekti është i vetëdijshëm me vështirësitë që një bashki përball me ndërmarrjen e hapave të duhur për zbatimin e kërkesave legjislative dhe për këtë arsye Projekti është duke zhvilluar Udhërrëfyesin 3R nëpërmjet shqyrtimit të mundësive të disa prej projekteve pilot 3R. Prandaj, pjesëmarrësit në seminar duhet ti

kushtojnë vëmendje ecurisë së projekteve pilot dhe të nxjerrin mësime prej tyre.

Përfaqësuesi nga bashkia Shkodër kërkoi të dinte efiçencën ekonomike që përfitonin nga këto projekte pilot pasi edhe bashkia e tyre në Shkodër kishte ndërmarrë të tilla projekte por kishin dështuar pasi nuk kishin gjetur treg shitje për të ricikluesshmet.

Z. Fujita u përgjigj se janë në dy muajt e parë të zbatimit të këtyre projekteve dhe se nuk e dinë tamam efiçencën ekonomike por që ata janë duke grumbulluar të ricikluesshme të cilave u kanë gjetur fillimisht tregun e shitjes.

Znj. Nishi ndërhyri për të shpjeguar matricën e vlerësimit të Projekteve Pilot e cila shpjegon qëndrueshmërinë dhe zbatueshmërinë e çdo PP, dhe kërkoi që pjesëmarrësit ta lexonin vetë këtë matricë, pasi koha e seminarit po mbaronte, dhe do ishin të lutur të dërgonin sugjerime mbi këtë matricë dhe gjithçka tjetër të paraqitur në këtë seminar.

Z. Baduni mbylli takimin duke falënderuar pjesëmarrësit për mendimet dhe komentet e dhëna, JICA që bëri të mundur materialin e prezantuar dhe shpresuar në vazhdimin e bashkëpunimit të nisur për të arritur objektivat e synuara. Gjithashtu, në emër të Ministrisë së Mjedisit, ai përcolli gatishmërinë për çdo koment, ndihmë apo sugjerim, për tu ndjerë të lirë që ti kontaktojnë.

6.2.4 Seminar për të prezantuar draftin e përfunduar Udhërrëfyesit 3R dhe raportimin e rezultateve të Projektit Pilot 3R (9 and 10 Mars, 2017)

A Programi

Programi

Ora	Programi	Nga
	Dita 1	
09:00 – 09:10	1. Hapja	MM
09:10 – 09:20	2. Prezantimi me njëri-tjetrin	
09:20 – 09:50	3. Prezantimi për Rezultatet e Projektit Pilot në Bashkinë Vau i Dejës	Bashkia Vau i Dejes
09:50 – 10:20	4. Prezantimi për Rezultatet e Projektit Pilot në Bashkinë Cërrik	Bashkia Cërrik
10:20 – 10:40	<< Pushim Kafe>>	
10:40 11:10	5. Prezantimi për Rezultatet e Projektit Pilot në Bashkinë Tiranë	Bashkia Tiranë
11:10 – 12:00	6. Shpjegimi i Udhërrëfyesit 3R	MM
12:00 – 13:00	<< Lunch >>	
13:00 – 15:00	7. Formulim i Planit të Veprimit 3R	EEJ
15:00 – 15:20	<< Pushim Kafe>>	
15:20 – 15:40	8. Prezantim i Planit të Veprimit 3R - Ura Vajgurore	Bashkia Ura Vajgurore
15:40 – 16:00	9. Prezantim i Planit të Veprimit 3R - Konispol	Bashkia Konispol
16:00 – 16:10	10. Fjala e mbylljes	MM
	Dita 2	
07:30 – 08:30	1. Udhëtim drejt Bashkisë Cërrik	
08:30 – 10:30	2. Vëzhgim i shërbimit të grumbullimit derë më derë (Përfshirë diskutim)	Bashkia Cërrik
10:30 – 11:30	3. Udhëtim drejt Tiranës	

B Lista Pjesëmarrësit

"Seminar për të prezantuar draftin e përfunduar të Udhërrëfyesit 3R dhe raportimin e rezultateve të Projektit Pilot 3R"
09 & 10 Mars, 2017

Nr.	Emer Mbiemer	Organizata	Dita 1	Dita 2
			Hotel Tirana International	Vizita në terren në Cërrik
1	Ledjana Karalliu	Ministria e Mjedisit	✓	
2	Polikron Horeshka	Ministria e Mjedisit	✓	
3	Jonida Hoxha	Ministria e Mjedisit	✓	✓
4	Dorina Xhurxhi	Ministria e Mjedisit	✓	
5	Isa Memia	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	✓	✓
6	Ermira Dedej	Ministria e Zhvillimit Urban	✓	
7	Sindi Lilo	Ministria e Zhvillimit Urban	✓	
8	Endrit Opingari	Bashkia Berat	✓	✓
9	Bektash Daja	Bashkia Berat	✓	
10	Shpetim Rama	Bashkia Bulqize	✓	
11	Qerim Baku	Bashkia Cerrik	✓	•
12	Flutura Xhelili	Bashkia Cerrik		•
13	Antike Torba	Bashkia Diber	✓	
14	Mario Maci	Bashkia Divjak	✓	✓
15	Suad Toshkallari	Bashkia Divjak	✓	✓
16	Leonidha Kaci	Bashkia Dropull	✓	✓
17	Rudina Trikshiqi	Bashkia Durres	✓	
18	Vivjana Bocaj	Bashkia Durres	✓	
19	Agim Lami	Bashkia Elbasan	✓	✓
20	Kristjan Vocri	Bashkia Fushe Arrez	✓	
21	Klementin Syla	Bashkia Fushe Arrez	✓	
22	Anastas Sotiri	Bashkia Gjirokaster	✓	✓
23	Tefta Dobjani	Bashkia Kavaje	✓	
24	Thoma Andrea	Bashkia Kolonje	✓	✓
25	Teuta Cakolli	Bashkia Konispol	✓	✓
26	Morena Sejko	Bashkia Konispol	✓	✓
27	Roland Daja	Bashkia Kruje	✓	✓
28	Artan Gjergji	Bashkia Kruje	✓	✓
29	Adriatik Carka	Bashkia Kucove	✓	
30	Ilirjan Llangozi	Bashkia Kucove	✓	
31	Afrim Petku	Bashkia Kukes	✓	✓
32	Fasli Germizi	Bashkia Kukes	✓	
33	Kreshnik Dishnica	Bashkia Lezhe	✓	
34	Eduart Alikja	Bashkia Librazhd	✓	✓
35	Irena Sinani	Bashkia Lushnje	✓	✓
36	Kledis Kukaj	Bashkia Malesia e Madhe	✓	
37	Ermal Gjonaj	Bashkia Maliq	✓	
38	Anesti Skenderaj	Bashkia Mallakaster	✓	✓
39	Elsid Zekaj	Bashkia Mallakaster	✓	✓
40	Arsela Caka	Bashkia Mirdite	✓	✓
41	Blerina Troka	Bashkia Patos	✓	✓
42	Anita Dhima	Bashkia Peqin	✓	
43	Nevila Bica	Bashkia Peqin	✓	
44	Engjell Nebiaj	Bashkia Permet	✓	✓
45	Frederik Pikuci	Bashkia Pogradec	✓	✓
46	Mehmet Kosuri	Bashkia Prrenjas	✓	
47	Gordana Karaj	Bashkia Prrenjas	✓	✓
48	Behar Ademi	Bashkia Puke	✓	✓
49	Elda Joran	Bashkia Pustec	✓	
50	Andoneta Jankulla	Bashkia Pustec	✓	
51	Habibe Hajdini	Bashkia Roskovec	✓	✓

"Seminar për të prezantuar draftin e përfunduar të Udhërrëfyesit 3R dhe raportimin e rezultateve të Projektit Pilot 3R"
09 & 10 Mars, 2017

Nr.	Emer Mbiemer	Organizata	Dita 1 Hotel Tirana International	Dita 2 Vizita në terren në Cërrik
52	Viktor Sakaj	Bashkia Roskovec	✓	
53	Areti Papadhima	Bashkia Sarande	✓	✓
54	Merushe Cali	Bashkia Shijak	✓	✓
55	Erisa Zela	Bashkia Shijak	✓	
56	Erkan Borici	Bashkia Shkoder	✓	✓
57	Sonila Hyesenbelli	Bashkia Skrapar	✓	✓
58	Gezim Shehu	Bashkia Tepelene	✓	✓
59	Aleksander Toti	Bashkia Tepelene	✓	✓
60	Blerta Dakli	Bashkia Tirane	✓	
61	Valentina Jance	Bashkia Ura Vajgurure	✓	✓
62	Shpresa Kola	Bashkia Vau I Dejes	✓	✓
63	Zija Gerbeti	Bashkia Vau I Dejes	✓	✓
64	Valbona Cobani	Bashkia Vlore	✓	
65	Engjellushe Lalaj	Qarku Gjirokaster	✓	
66	Ylli Aliko	Qarku Gjirokaster	✓	✓
67	Sokol Berisha	Qarku Shkoder	✓	
68	Linda Bala	Qarku Shkoder	✓	✓
69	Vangjush Dishnica	Qarku Korce	✓	✓
70	Anila Gjykshi	Qarku Elbasan	✓	
71	Anila Hitaj	Qarku Vlore	✓	✓
72	Leonard Gjanci	Qarku Korce	✓	✓
73	Denada Gjogu	Qarku Berat	✓	✓
74	Bedrie Cenaj	Qarku Kukes	✓	✓
75	Odeta Jahaj	GIZ	✓	
76	Eno Dodbibaj	GIZ	✓	✓
77	Sokol Konomi	JICA	✓	
78	Mana Nagashima	JICA	✓	✓
79	Hiroshi Fujita	EEJ	✓	✓
80	Chiaki Nishi	EEJ	✓	✓
81	Shinnosuke ODA	EEJ	✓	✓
82	Koji Kusunoki	EEJ	✓	✓
83	Kreshnik Bajraktari	EEJ	✓	✓
84	Ela Muka	EEJ	✓	✓
85	Besjan Lako	EEJ	✓	✓
86	Dea Bala	EEJ	✓	
87	Edlira Tare	EEJ	✓	

C Procesverbali i Seminarit

Procesverbal i Seminarit

9 Mars 2017

Seminari u zhvilluar sipas axhendës.

Përmbledhja e Q & A tregohet më poshtë.

Q & A (1)

[Q.1] Një pyetje erdhi nga Z. Sokol Konomi, Koordinator i Zyrës së JICA në Ballkan për Shqipërinë: Cila ishte arsyeja e dështimit të grumbullimit të materialit të ricikklueshëm në burim?

- Z. Qerim Baku u përgjigj që shtëpiaket nuk janë shumë të kujdesshme.
- Z. Koji Kusunoki shpjegoi disa arsye të tjera për dështimin. Ai përmendi që në zonën e qytetit, shërbimi i grumbullimit është me kontejnerë dhe mbizotërojnë pallatet. Në zonën rurale me grumbullimin derë më derë, grumbullimi i të ricikluesshmeve ishte më i suksesshëm.

Q & A (2)

Z. Hiroshi Fujita shpjegoi modelin e Udhërrëfyesit 3R. Ai gjithashtu përmendi që të gjitha bashkitë do ta kenë këtë Udhërrëfyes në fund të Prillit.

[Q.2] Pyetje nga Z. Zija Gerbeti:

1) A duhet që MM të rregullojë marrëdhënien ndërmjet projekteve të ndryshëm në Shqipëri dhe bashkisë? Në mënyrë që hapat të zhvillohen nga fillimi deri në fund?
2) A duhet të ketë bazë ligjore për marrjen e masave ndaj shkelësve?
3) A duhet të hapen tregje riciklimi për gjithçka?

Përgjigja nga Znj. Lediana Karalliu:

1) Ato duhet të zhvillohen njëkohësisht.
2) Baza ligjore ekziston dhe është ligji për pastrimin e mbetjeve por ky është një ligj që duhet rishikuar. Ne jemi të vetëdijshëm për këtë dhe shumë shpejt do e rishikojmë dhe vendosim masat shtrënguese për të gjitha NjQV-të.
3) Do të thoja që nuk ka vetëm treg për riciklimin e metaleve apo riciklimin e plastikës. Sot ne kemi riciklimin e vajrave të përdorur, baterive të përdorura, gomave të përdorura, për çdo rrymë mbetjesh dhe unë mendoj që kemi problem me ndërgjegjësimin publik, i cili duhet të kryhet, jo vetëm nga MM por nga çdo NjQV dhe bashki sepse pas ndërgjegjësimit ne nuk do të lejojmë që njerëzit të zbrazin mbetje në rrugë apo lumenj dhe të ndotin mjedisin.

[Q.2] Përfaqësuesi nga Bashkia Elbasan – Ne pamë që PP janë kryer në zona që nuk klasifikohen si bashki të mëdha. Çfarë është marrë në konsideratë dhe pse ky PP nuk është kryer në një bashki me shkallë të madhe?

- Znj. Lediana: Projekti ka filluar dhe është zbatuar në tre NjQV, që u zgjodhën sipas madhësisë së tyre. Vau i Dejës, Komuna Bushat si një NjQV e vogël, Cërrik si një NjQV e mesme dhe Tirana si një NjQV e madhe. Pastaj, u vendos që në 7 Qarqe, rreth 40 Bashki, EEJ do të marrë informacion mbi problematikat e tyre, mbi sfidat që kishin këto bashki dhe të asistonin në formulimin e një plan veprimi për to.
- Bashkia Elbasan: Unë po flisja për problematikat. Ky projekt që është kryer në këto zona është i shkëlqyer por problematikat në një bashki të madhe janë shumë më të mëdha dhe kërkojnë vëmendje të madhe. Prandaj, nëse ne mendojmë që në këto qytete të vogla, ndërgjegjësimi i njerëzve për ndarjen dhe 3R është i thjeshtë, në një qytet që ka më shumë

se 150.000 banorë, vetëm qyteti pasi së bashku me fshatrat janë rreth 250.000 banorë, problematikat janë më të ngjeshura dhe më të mëdha. Ky projekt do të shërbente më shumë nëse do të zgjidhej të paktën një bashki e madhe si model.

- Znj. Lediana: Është zgjedhur Bashkia Tiranë. Nuk mendoj se ka një bashki më të madhe se Tirana.
- Bashkia Elbasan: Edhe në Bashkinë Tiranë, projekti është kryer vetëm në 5 shkolla në Laprakë.
- Znj. Lediana: Ne duhet të zgjidhnim disa nga ato pasi ne nuk mund të punonim me të gjitha shkollat e Tiranës.
- Bashkia Elbasan: Ideja ime ishte rreth problemeve të një bashkie në përgjithësi, jo të specifikuar vetëm për shkollat.
- Znj. Lediana: Është menduar të punohet me këto 5 shkolla dhe më pas ky draft Udhërrëfyes dhe gjithë problematikat që ne hasëm, do të shpërndahen gjithashtu në bashkitë e tjera, por kjo është për të ardhmen, jo për momentin.
- Bashkia Elbasan: Pyetja ime e dytë ka të bëjë me pjesën e mbetur të menaxhimit. Kemi bashki që kanë landfill, kanë filluar ndërtimet e landfilleve në të gjithë vendin, por ka bashki të cilat nuk kanë. Përfitoj nga rasti, nëse ka ndonjë përfaqësues nga Bashki Fier, pasi ata kanë përgatitur një PP për vendosjen e kontejnerëve. Do të doja të dija koston e këtij PP, sepse më pëlqeu si projekt dhe mund të zbatohet në të gjitha qytetet, dhe me atë lloj ndarje dhe konstukt kontejneri, ndihmon në riciklimi e mbetjeve që në venddepozitim. Faleminderit.
- Znj. Lediana: Nuk e di, është ndonjë përfaqësues nga Bashki Fier?

- Z. Hiroshi Fujita: Shpjegimi për zgjedhjen e 3 qyteteve pilot.

  Është jashtë kontrollit tonë se kur e fillojmë projektin, prandaj zonat e synuara ishin te vendosura më parë. Kur ne filluam, vendet e projektit pilot ishin Tirana, Lezha dhe Komuna Bushat. Kur ne filluam vëzhgimin bazë, kur vizituam Lezhën, Swiss Corporation kishte filluar disa aktivitete në Lezhë. Prandaj ne zhvilluam disa diskutime me veten tonë, zyrën e kryeministrit, MM, për të ndryshuar zonën e synuar për projektin pilot të zonës së mesme. Në fillim, MM dhe Qeveria Japoneze zgjodhën Tiranën, Lezhën dhe Bushatin, ndoshta duke pasur si qëllim që qytetet e mëdha kanë probleme specifike, dhe qytetet e mesme dhe të vogla. Prandaj ata zgjodhën këto të treja. Zhvillimi i mbështetjes nga Qeveria Japoneze, në krahasim me vendet e tjera të BE është ndryshe. Për shembull, DLDP mbulon të gjithë bashkinë Shkodër ndërsa stili joně nuk është të mbulojmë gjithë bashkinë. Ne kryejmë një aktivitet në shkallë të vogël dhe më pas, bazuar në këtë eksperiencë, e përhapin në këtë bashki dhe ndonjëherë në bashki të tjera. Kjo është metoda e asistencës Japoneze.

[Q.2] Përfaqësuesja nga Saranda:

Plan Veprimi 3R që ne po diskutojmë dhe kemi rreth tre vite, është një detyrim për qeveritë lokale për ta hartuar dhe zbatuar. Ndërkohë, ligji për menaxhimin e mbetjeve të integruara, strategjia kombëtare e mbetjeve, etj. kanë përcaktuar detyrimet për qeveritë lokale, zhvillimin e planeve lokale të menaxhimit të mbetjeve. Këto plane lokale kanë të gjitha rrymat e mbetjeve. Në gjithë diskutimin që po mbahet, është menaxhimi i mbetjeve urbane. Nuk e di nëse ky plan veprimi do të jetë pjesë e planit lokal të menaxhimit të mbetjeve, por ne nuk po diskutojmë rrymat e tjera të mbetjeve. Ndoshta nuk është pjesë e kësaj që ne po diskutojmë sot, por unë, në pozicionin që jam, kam probleme pasi në landfillin e Sarandës, është një listë me rrymat e mbetjeve që mund të depozitohen dhe kam problem me disa rryma të tjera mbetjesh si mbetjet e ngurta, inertet, etj. Momentalisht ne nuk kemi një landfill për mbetje të tilla dhe kemi vështirësi pasi nuk kemi vend në zonën tonë për ta bërë një. Kërkojmë ndihmë nga MM, MTI, Këshilli, për të përcaktuar këto sepse MM nëpërmjet inspektoriatit mjedisor

kanë vendosur gjoba për qeveritë lokale. Kjo ka për të ndodhur përsëri sepse ne nuk kemi mundësi reflektimi. Dua një mendim nga MTI, MM se si duhet të veprojmë dhe çfarë duhet të bëjmë.

- Znj. Lediana: E kuptoj shqetësimin tuaj, është një shqetësim të cilin ne e kemi diskutuar në takime të ndryshme brenda MM dhe me MTI. Ne diskutuam krijimin e një landfilli për inertet, i cili deri më sot nuk ekziston brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por është parë më emergjente ndërtimi i landfilleve për mbetjet bashkiake pasi mbetjet zbrazen në venddepozitime jashtë çdo norme. Ndotin tokën dhe sipërfaqet ujore, etj. prandaj ka mbetur deri më sot pa u ndërtuar, megjithatë, shqetësimi është në prioritetet tona.
- Bashkia Sarandë: Është shqetësimi juaj dhe i joni, por kur është penalizuar Bashkia Sarandë, nuk është penalizuar për mbetjet urbane por për mbetjet e ngurta dhe ka për të ndodhur përsëri nëse ata vijnë përsëri. Duhet të reflektohet, por për ne është e pamundur. Ne kishim një venddepozitim mbetjesh në rehabilitim dhe ne vazhdojmë të zbrazim atje mbetjet që landfilli nuk i pranon.
- Znj. Lediana: Të paktën ato mund të përdoren për të mbushur gropat në rrugë në mënyrë që të pakësohet sa të jetë e mundur kjo sasi mbetjesh ose mbetjet e tjera që mund të eksportohen nga kompani që menaxhojnë këto lloj mbetjesh.
- Z. Isa Memia: Ne kemi dërguar një VKM (Vendim i Këshillit të Ministrave) për menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit ku janë të përcaktuara qartë dhe si do të veprojë bashkia, ku sipas kësaj VKM ka të drejtë të miratojë një venddepozitim të përkohshëm, me përmbushjen e disa kritereve të përcaktuara në VKM dhe venddepozitime të përhershme. Në çdo rast, njësitë e qeverisjes lokale, gjatë dhënies së lejes për ndërtime të reja apo riparime, sipas VKM është lënë që këta të mund të përcaktojnë një tarifë dhe kjo tarifë mund të përdoret për menaxhimin e këtyre venddepozitimeve të përkohshme apo të përhershme. Në VKM janë të përcaktuara qartë fuqitë e bashkisë dhe atyre që prodhojnë këto lloj mbetjesh.
- Znj. Valentina Jance: Në lidhje me problemin që po diskutojmë, një problem që un mendoj se e kanë të gjitha bashkitë, është në momentin që ju hartoni buxhetet për këtë problem. Na është premtuar një manual por deri më sot ne nuk e kemi këtë manual dhe puna deri më sot është kryer duke pyetur njëri-tjetrin për tarifat. E di që ka filluar një proces për hartimin e një manuali për koston dhe tarifën, kur mund ta kemi ne atë?
- Znj. Lediana: Është në fazën e diskutimit ndërmjet ministrive. Do të jetë një projekt vendim dhe jo një manual, i cili do të jetë detyrues për të gjitha bashkitë dhe aty do të vendosen modelet e kostos dhe llogaritja e tarifës.
- Z. Hiroshi Fujita: Tani ju përmendët disa kosto dhe vlerësime ekonomike. Për aktivitetet 3R është e vështirë të vlerësohet se sa është e nevojshme sepse varet se çfarë lloj impianti ju keni, sa njerëz ju keni dhe sa janë të ardhurat për menaxhimin e mbetjeve. Është shumë e ndryshme. Në Udhërrëfyes ne kemi shpjeguar disa aktivitete dhe shënuar koston. Për aktivitetet e kryera në 3 bashkitë e projektit pilot, ju do të gjeni një kosto shumë të detajuar për fletëpalosjet, koston e printimit, etj. Kjo është e shkruar në raportet tona.

Në fund të seminarit, Z. Sokol Konomi, Koordinator i Zyrës së JICA, mbajti fjalën e mbylljes si më poshtë:

> Përshëndetje zonja dhe zotërinj. Jam i befasuar në lidhje me pjesëmarrjen dhe interesin e treguar nga ju për aktivitetin e sotëm, prandaj në emër të Agjensisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), do të doja t'ju falënderoja për kohën e shpenzuar dhe ardhjen këtu sot, dhe interesin e treguar për gjithë procesin. Nëpërmjet këtij projekti, JICA synon të mbështesë Shqipërinë në aspiratat e saj për tu futur në BE. Ndër kategoritë e shumta të Shqipërisë për tu bërë pjesë e BE është gjithashtu menaxhimi i integruar i mbetjeve. Kjo gjë, herët apo vonë do të ndodhë, prandaj çdo njësi e qeverisjes vendore është e detyruar që në një moment të caktuar

të krycjë menaxhimin e mbetjeve në mënyrë të integruar. Ky Udhërrëfyes që u prezantua sot këtu, nuk është vetëm një instrument që adreson çështjet e riciklimit apo 3R-ve. Në fakt është një dokument që i shërben në mënyrë praktike çdo njësie të qeverisjes lokale për të vendosur se si të bëjnë vlerësimin e situatës së tyre për gjendjen e mbetjeve të ngurta, për të arritur në pikëpamje sasiore dhe cilësore dhe të arrijnë në përfundimin për ta krijuar vetë, duke u mbështetur në Udhërrëfyes, se çfarë rruge duhet të ndjekin ose çfarë drejtimi ti japin çështjes së menaxhimit të integruar të mbetjeve për njësinë e tyre. Prandaj është një instrument shumë i rëndësishëm në duart e qeverive lokale për të orientuar praktikisht bashkitë drejt stabilizimit të procesit të menaxhimit të mbetjeve në mënyrë të integruar. Uroj që ta përqafoni këtë Udhërrëfyes dhe ta ktheni atë në një metodologji që do ju çojë drejt suksesit në menaxhimin e integruar të mbetjeve. Faleminderit shumë dhe ju uroj sukses.

- I azhornuar-

D Presentation Material

D.1 Vau i Dejes PP



Mjetet në zotërim nga bashkia

U nevojitën 45 minuta për të mbuluar vetëm një kontejner. Sigurisht, jo gjithë kontejnerët janë në një gjendje të tillë, por kontejnerët problematikë nuk janë pak.
Progresi i PP tregoi që shërbimi i rregullt i grumbullimit me kompaktor është më efektiv se ai me kamioçinë. Gjithsesi Megjithatë, është e domosdoshme të ndryshohet mënyra e zbrazjes për të arritur një më të mirë.

Supozohet se do të duhen vetëm 5 minuta nëse mbetjet zbrazen brënda në kontenier.

Tabela e Regjistrit

Mesatarja mujore	Kompaktori Nëntor-	Mjeti i vogel Nënt-
Udhëtime	31.1	**9.4
Distanca e mbuluar	1,030 km	-
Orët e punës	116.6hours	-
Kontejnerët e mbuluar	1,068	-
Pesha e grumbulluar	127,711 kg	**25,677 kg
Mesatarja (kg/udhëtim)	3,930kg	2,732 kg
Konsumi i karburantit(Çmim, Lekë)	90,759	*18,600
Konsumi i karburantit (litër)	588	*121.1
Njësia (Litër/ton)	4.6	*5.4
Njësia (Lekë/ton)	711	*836

*Të dhënat janë nga regjistrimet e pasrimit për një periudhë 4 mujore, Dhjetor- Mars, dhe karburanti është përdorur për mjetin ngarkues dhe mjetin e vogël gjatë kësaj periudhe.
**Të dhënat përfshijnë pasrimin për grumbujt e mëtëhenj të mbetjeve bujqësore e cila u realizau nga bashkia në Nëntor.

Faza 2

Periudha e zbatimit	Shk - Tet, 2016
Objektivat	Të krijojë sistemin e përshtatshëm të zbrazjes se mbetjeve që do të ndiqet nga qytetarët
Zona e synuar	Barbullush, Kranxë, Bushat, Kosmac, Melgushë
Fusha e synuar	Pika e zbrazjes e përcaktuar për mbetjet bujqësore (4 pika) në 3 fshatrat e synuar.
Çështjet	Mënyra e papërshtatshme e zbrazjes nga qytetarët ka ulur efikasitetin e grumbullimit. Veçanërisht, problemet serioze janë se mbetjet e përgjithshme shpërndahen në terren e nuk zbrazen brenda kontejnerit dhe sasi masive e mbetjeve bujqësore zbrazet rreth kontejnerit.

Për të shmangur situata të tilla, nevojitet një rregull i ri zbrazje.

Me qëllim përcaktimin e rregullave që njerëzit të mos kryejnë zbrazje në mënyrë të paligjshme

Mbetje të përgjithshme	Mbetje bujqësore dhe të gjelbra
Duhen zbrazur në mënyrë të përshtatshme brenda kontejnerëve.	Duhen zbrazur të ndara në përputhje me mënyrat e përcaktuara. Për shembull, një kontejner tjetër ose vend i përcaktuar vetëm për këto mbetje

Faza 2: Procedurat

1. Të identifikojë veçanërisht vendet problematike në drejtim të mënyrës së zbrazjes dhe të përzgjedhë pikat pilot.
2. Të formulojë metodën e duhur të zbrazjes për mbetjet bujqësore (Është marrë parasysh instalimi i kontejnerëve të mëdhenj të përcaktuar për mbetjet bujqësore dhe është studiuar tashmë vlefshmëria e tyre.)
3. Të zhvillojë takime me banorët të cilët ndoshta do të jenë të mbuluar në kuadër të pikave pilote me qëllim shkëmbimin e ideve dhe njoftimi i sistemit të ndarjes, paralelisht me pikat e lartpërmendura 1 & 2.
4. Të fillojë një sistem të ndarë zbrazjesh pasi pikat e zbrazjeve të jenë vendosur fizikisht
5. Të rrisë ndërgjegjësimin e publikut përmes aktivitetit monitorues mbi progresin dhe gjendjen e pikave pilot.

Fletëpalosja iu shpërndaj çdo familjeje nëpërmjet vizitës shtëpi me shtëpi.

Tabela e Rezultatit

Muaji	Pesha e përgjithshme e transportuar (ton)	Numri i Rrugëve
Prill	11.3	5
Maj	5.8	4
Qershor	7.4	4
Korrik	9.7	7
Gusht	9.5	8
Shtator	9.9	8
Tetor	9.1	8
Nëntor	15.5	8
Dhjetor	7.7	7
Mesatare	9.0	6.3

*Nga Nëntori, 4 kontejnerë janë shtuar në fshatin Bushat kështu që ato shifra janë përjashtuar nga mesatarja.

Faza 3

Periudha e zbatimit	Shkurt – Dhjetor, 2016
Qëllimi	Vendosja e një mënyre të përshtatshme për pakësimin e mbetjeve
Zona e Synuar	Barbullush, Rranxe
Fusha e synuar	Familjet per kompostimin e mbetjeve bujqësore (janë perzgjedhur 4 familje jne 2 fshatrat e synuar.
Çështjet	Zbrazen sasi të medha te mbetjeve bujqesore. Deri me tani bashkia duhet ti transportoj dhe depozitoj ato. Do te ishte ideale nese këto lloj mbetjesh nuk do te zbrazeshim por te trajtoheshin nga komuniteti, p.sh. te kompostoheshin.

Sasi të mëdha të zbrazura të mbetjeve bujqësore. Bashkia është përgjegjëse për transportin e tyre në Landfill. Por do të ishte ideale nese banorët nuk do të zbrazinin këto lloj mbetjesh por të fillonin vetë trajtimin e tyre, p.sh. ti kompostojnë.

Teoria e përgjithshme e kompostimit

	Kompostim brënda oborrit	Kompostim jashtë oborrit
E përgjithshme	Zhvillohet në burimin gjenerues (kryesisht familje) të mbetjeve të synuara në shkallë të vogël në disa vende. Parimisht duhet të bëhet mbi baza vullnetare nga qytetarët në vënd të operimit nga bashkia.	Zhvillohet në vende të caktuara në shkallë të madhe në të cilën zbrazen vetëm mbetjet e synuara. Administrata e njësisë vendore zakonisht organizon funksionimin.
Avantazh	• Me pak ngarkesë financiare për operimin nga ana e bashkisë. • Efektive për pakësimin e sasisë së mbetjeve të transportura dhe depozituara në landfill.	• Great effective to the reduction of landfilled amount since it is intensively treated Shumë efektive për pakësimin e sasisë së mbetjeve që do të depozitohen në landfill
Disavantazh	• Është e kufizuar për tu shpërndarë për familjet dhe në këtë mënyrë pakësimi për sasinë e mbetjeve që do të depozitohen në landfill është më pak efektive. Kërkon përpjekje nga ana e bashkisë për ta përhapur këtë praktikë.	• Është jo efektive për të pakësuar sasinë e transportuar dhe ka një kosto për grumbullimin e ndarë. • Funksionimi mbulohet nga bashkia. • Duhet që mbetjet e synuara të ndahen.

PP fokusohet në kompostimin brënda oborrit duke qënë se kompostimi jashtë oborrit kërkon mbulimin nga ana e bashkisë, dhe ka ende probleme me transportimin e mbetjeve që duhen për të pakësuar sasinë e mbetjeve që do të grumbullohen.

Vëzhgimi mbi vizitat në shtëpi

1. Rreth 30 % e banorëve kompostojnë në njëfarë mënyre disa mbetje edhe pse vazhdojnë dhe zbrazin disa.
2. Sidoqoftë, pothuajse të gjitha familjet që nuk kompostojnë nuk kanë dëshirë të jenë pjesë e aktivitetit.

"Këtu fjala "mbetje" nuk përfshin kashtën apo kallëmat e mistrit që përdoren si shtresë për bagëtinë. Norma e riciklimit për këtë aktivitet është shumë e larte në zonë.

Shtëpitë që kompostojnë.

Kompostimi brënda-oborrit, nisur nga vëzhgimi me anë të Projektit Pilot është një praktikë shumë e rëndësishme për pakësimin e mbetjeve organike të zbrasura në Bushat. Për më tepër numri i banorëve, që pranojnë të kompostojnë, është shumë i limituar. Për këtë arsye përhapja e mëtejshme e një veprimi të tillë është sfidë e pashmangshme për periudhën e ardhshme. Për zgjidhjen, p.sh pritet që bashkia të parashikoj përjashtimin nga taksat e mbetjeve për familjet që kompostojnë ose autoritetet qendrore marrin iniciativën për të kontrolluar shkarkimin e mbetjeve organike bujqësore në nivel mbarëkombëtarë.

Përmbledhje përfundimtare e PP (1)

Faza 1	Faza 2	Faza 3
PP përmirësoi shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, duke mbuluar 300 kontenier të vegjël. Shërbimi vazhdon rregullisht edhe pas përfundimit të PP. Grumbullimi bëhet një herë në javë për çdo kontenier. Sidoqoftë PP nxorri në pah problemin mbi grumbullimin e mbetjeve të zbrazura masivisht (kryesisht mbetje organike) pranë kontenierëve.	U instaluan kontenierët e mëdhenj për zbrazjen e mbetjeve bujqësore dhe të gjelbërta për zgjidhjen e problemit. PP shërbeu dhe për vëzhgimin e cilësisë së mbetjeve dhe nivelin e bashkëpunimit të banorëve në mënyrë pakësimin e mbetjeve për faziin tjetër. U vu re që pikat e zbrazjes mbahen pastër dhe grumbullimi i tyre është efiçent . Edhe pse problemi i fazës së parë u zgjidh, faza 2 nxorri në pah sfidën e ardhshme dhe nevojën për të pakësuar mbetjet që do të trasportohen duke qënë se bashkia duhet të transportoj sasi të mëdha të mbetjeve bujqësore dhe të gjelbërta.	Kompostimi brënda oborrit nuk është në gjendje të pakësoj sasinë e mbetjeve që do të trasportohen. Kjo është një arsye pse kompostimi brënda oborrit i përshtatet bashkive që kanë probleme me transportimin e mbetjeve, duke qënë se pakëson sasinë e mbetjeve që trasportohen. Ndaj PP u fokusua në kompostimin brënda oborrit. Metoda të ndryshme të kompostimit janë vënë re gjatë vëzhgimit. Ndaj kompostimi duhet përhapur për të rritur efiçencën e transportit të mbetjeve dhe promovimin e 3R-ve. Bashkia dhe autoritetet qëndrore duhet të bashkëpunojnë mbi këtë çështje.

Përmbledhje Përfundimtare e PP(2)

Tabela, sasia e mbetjeve e transportuar nga NjA Bushat

Kategoria e Mbetjeve	Kategoria e Transportit	2014 (Përpara PP)	2016 (Mesin e PP)	2018 (Shembuli i ardhshëm)
Mbetjet e përgjithshme të synuarara	Kontenierët Bashkëjetë (PP1)	27.5 ton/muaj	127.7 ton/muaj	127.7 ton/muaj
	Kontenierët Mënë-larësuar	42.0 ton/muaj	0.0 ton/muaj	0.0 ton/muaj
Mbetjet bujqësore të supozuara por 2014	Kamioni i Hapur Bashkëjetë	33.3 ton/muaj	16.7 ton/muaj	0.0 ton/muaj
	Kamioni i Kontejnerëve të Mëdhenj (PP2)	0	9.0 ton/muaj	25.7 ton/muaj
	Totali	**102.8 ton/muaj**	**153.4 ton/muaj**	**153.4 ton/muaj**

* Në 2014, supozohet që kamionët e hapur janë përdorur për të grumbulluar mbetjet e përgjithshme si konsiderueshëm të zbrazura në çdoë.

PP1 shërbeu për unifikimin e sistemit të transportit dhe rritjen sasi që transportohet.
PP2 shërbeu për të demonstruar mundësinë e sistemit me kontejnerë të mëdhenj.

D.2 Cerrik PP


Projekti Pilot
në Bashkinë Cërrik
Mars, 2017
Bashkia Cërrik
Ekipi i Ekspertëve të JICA
Çështjet e tanishme të MMN(1)
Çështjet e tanishme të MMN(2)
Qëllimet e Projektit Pilot 3R
Projekti Pilot 1
Projekti Pilot 2
PP 1: Përmirësimi i zbrazjes të mbetjeve bashkiake dhe grumbullimi në zonën rurale
1.1 Skica e PP dhe zona e synuar
1.2 Zona e synuar
1.3 Skica e PP

PP 1: Përmirësimi i zbrazjes të mbetjeve bashkiake dhe grumbullimi në zonën rurale
Vendi i zbrazjes dhe koha 2: zbrazje drejtpërdrejt në mjetin e grumbullimit

PP 1: Përmirësimi i zbrazjes të mbetjeve bashkiake dhe grumbullimi në zonën rurale
Sistemi i grumbullimit: grumbullim derë-më-derë me sistem zanor

PP 1: Përmirësimi i zbrazjes të mbetjeve bashkiake dhe grumbullimi në zonën rurale
Situata e mbetjeve të shpërhapura në zonë


PP 1: Përmirësimi i zbrazjes të mbetjeve bashkiake dhe grumbullimi në zonën rurale
1.4 Monitorimi i rezultatit të PP

PP 1: Përmirësimi i zbrazjes të mbetjeve bashkiake dhe grumbullimi në zonën rurale

PP 1: Përmirësimi i zbrazjes të mbetjeve bashkiake dhe grumbullimi në zonën rurale


PP 1: Përmirësimi i zbrazjes të mbetjeve bashkiake dhe grumbullimi në zonën rurale
Hapi 1
Hapi 2
Hapi 3

PP 1: Përmirësimi i zbrazjes të mbetjeve bashkiake dhe grumbullimi në zonën rurale
1.5 Gjetje
• Si sistem grumbullimi në zonën rurale, është vërtetuar se sistemi i grumbullimit derë-më-derë me sistem zanor është efektiv dhe ndihmoi në zbukurimin e zonës. Megenëse gjendja e disa zonave është e ngjashme me zonën e PP, sistemi i grumbullimit derë-më-derë është i mundur të zgjerohet edhe në këto zona nga eksperienca e PP.
Ky dokument e dhe kartat si nje manual per Mbeshtetje e Mjeshtërit (MM) per te perkrahur bashkitë te cilat formulojë PV-3R, udhëzojnë organizimet te sensibilizuarve dhe vendosë individuale ne bashki.

2 Ndarja e Roleve

Organizata kryesore per formulimin dhe mbeshtetjen e PV-3R, sikësi MM, Qarqet dhe Bashkitë. Roli i çdo organizate jepet ne tabelën 2-1.

Tabela 2-1 Organizatat kryesore dhe ndarja e roleve per formulimin dhe mbeshtetjen e PV-3R

Organizata	Ndarja e roleve
MM	• Përgatitja e programit per PV-3R. • Per te dërguar qëllimin e seminarit, njerin dhe lëndën a personave te ftuar Qeveritë dhe u ofrojnë qe te fitojnë bashkitë ne seminare. • Per te përgatitur materiale dhe pajisje per seminar. • Per te shpjeguar, perfituar e PV-3R, qëllimin e formulimit te PV-3R, metodat e kujdesit te fushes se mbetjeve, per te kuptuar gjendjen e tanishme dhe çështje te MMN dhe per te perzgjedhur aktivitete 3R ne seminar. • Per shpjegimit, personat qe mohin pjese e perzgjedhjes per MMN nga bashkitë, hedhin te dhënat per njerin e mbetjeve, gjendjen e tanishme dhe çështje te MMN, ne formulim e PV-3R, instalues paraqitjeve ne kompiuter nga MM. • Per te regjistruar ne shkarte te arritjeve per pjesëmarrësit ne fushën e monitorimit. • Per te bërë hapja telefonike dhe / ose e-mail per secilën bashki per te ndihmuar përgatitjen e tyre ne përgatitjen e PV-3R. Bashkitë te cilat nuk janë prezentë ne seminar do te kërkohet nëse kanë nevoje per instruksione, dhe bashkia ne bazë te kërkesës do te vërtetohet. • Per te dhënë mbeshtetje bashkive per te cilat kosta ne formulimin e PV-3R nga ashtë e tanishme si rezultat i vaskërrit te PV-3R formuluar dhe pranë bashkitë. Dhe gjithashtu te japë mbeshtetje per bashkitë te cilat nuk janë pjesëmarrëse ne seminar dhe duan te marrin udhëzime per formulimin e PV-3R. • Per te paraqitur rezultatet e PV-3Rformuluar nga bashkitë.
Qarqet	• Sipaz kërkesës se MM, te dërgojë qëllimin e seminarit, programin pjesëmarrësve dhe te promovojë pjesëmarrjen ne seminar. • Te përgatitë vendin per Seminar. • Te vëzhgojë situatën që bashkitë te marrin pjesë ne seminar dhe te formulojnë PV-3R.
Bashkitë	• Te marrin pjesë ne seminarin e përgatitur nga MM dhe promovuar nga Qarqet. • Te marrin pjesë ne seminar dhe te promovojnë PV -3R. • Ti jepëzojë PV-3R nëpërmjet Qarqeve, Ministrisë se Mjedisit.

1

Republika e Shqipërisë
Projekti Mbështetje per Minimizimin e Mbetjeve dhe Promovimin 3R
Manual per mbeshtetje te formulimit Planit te Veprimit 3R
JICA
KKC / EXRI

	• Bashkitë te cilat dëshrojnë mbeshtetja per formulimin dhe/ose gjykohet ne progresi per formatimin PV-3R nuk ashtë e tanishme nga MM dhe/ose e Qarqet marrin mbeshtetje individuale.

3 Caktimi i mbajtjes se seminarit dhe përgatitja e Planit te Veprimit 3R

Seminari per mbeshtetjen per te formuluar PV-3R mbahet ne bazë ne rathdy ojet. Kur Udhëzimi per 3R sukcesohet dhe/ose politika per minimizimin e e mbetjeve te njësisë kërkesës ashtë ndryshuar, ashtë e nevojshme mbajtja e nje seminari.

Programi i Seminarit mbahet duke patur parasysh pjesët e mëposhtëme,

Seminari mbahet nga çdo Qark
Vendi i organizimit te seminarit perzgjedhjen qpas distancës si gjeografikisë.
Ne parim, seminari mbahet per nje ditë, por ne rast te ka bashki, ka fushata ofiziatë ashtë e gjatë dhe kjo ndikon kohë perudhëshëm, seminari mbahet ne gjysëm te mëngjesit te Qarkut dhe per te arrëqëkur bashki mbi bashkitë pjesëmarrëse.
Orari ashtë regullisht ne ditë te renovuara pasur parasysh se bashkitë mbi jane ne gjendje te marrin pjesë per-ishuqe te parimangjisme.
Orari regullisht duke marrë parasysh që udhëtojnë ne distancë dhe kohë nga vendi ku mbahet seminari ne vendin tjetër.

Programi per perfundimin e PV-3R jepet ne tabelën 3-1. Hevegjen rreth 10 muaj per te dorëzuar PV-3R te perfunduar MM.

Muaj	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgatitja e seminarit per te mbeshtetur NJQV-të te formulojnë Planin e Veprimit 3R/Seminar per PV-3R										
Te mbajë seminar per PV- 3R ne çdo qark										
Te mbajë PV-3R										
Vizita individuale ne çdo NJQV										
Te dorëzoj PV- 3R MM drejpërdrejë ose nëpërmjet Qarqeve										

Figura 3-1 Programi per përfundimin e PV-3R

2

Republika e Shqipërisë
Projekti Mbështetje per Minimizimin e Mbetjeve dhe Promovimin 3R
Manual per mbeshtetje te formulimit Planit te Veprimit 3R
JICA
KKC / EXRI

Tabela 3-1 Shëmbuj per programin e seminarit per mbeshtetje per të formuluar PV-3R

No	Aktivitet	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]
[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]	[illegible]


4.1.1 Material per shpjegimin e Planit te Veprimit 3R
4.1.2 Formati i formulimit te Plan Veprimit 3R
Plani Veprimit 3R




4.1.3 Simulimi i programit per te krijuar nymen e mbetjeve
4.1.4 Fleta per monitorimin per formulimin e Plan Veprimit 3R

4.2 Ndjekja për të formuluar Planin e Veprimit 3R

MM dhe/ose Qarku bëjnë telefonata çdo bashkie për ti gjytur në lidhje me ecurinë e tyre në përgatitjen e PV-3R. Për bashkitë të cilat nuk janë të pranishme në seminar pyeten nëse kanë nevoja për udhëzime, dhe vizitohen sipas kërkesës së tyre. Bashkitë të cilat përfundojnë plotësimin e pjesës në lidhje me gjendjen e tanishme të MMN, përmes letës) procesi ia zëvën me e-mail MM dhe/ose Qarqeve.

Në mënyrë që të zgjidhen bashkitë të cilat njoftohen se janë me nevoj për ndjekje të mëtejshme, përmbajtja mbi gjendjen e MMN plotësuar nga bashkitë kontrollohet me atë që u plotësua gjatë seminarit, dhe shkallës e ecurisë vlerësohet në termat e katër pjesëve renditur më poshtë sipas 5 shkallëve (5: më shumë se 80%, 4: 79-60%, 3: 59-40%, 2: 39-20%, 1:mën 10%). Kjo ofron bazën për të gjykuar se në cilën pjesë duhet të përqendrohen kur u ofrohet mbështetje e mëtejshme.

Gjendja e tanishme e MMN

Rryma e tanishme e mbetjeve

Gjendja e tanishme financiare e MMN

Çështje dhe shqetësime lidhur me MMN

Tabela 4-1 Fleta e vlerësimit të Ecurisë për formulimin e PV-3R nga çdo njësi vendore-

Bashkitë		Vlerësimi i Ecurisë						Shënime
		Grand	Gjendja e tanishme	Rryma e mbetjeve	Gjendja financiare	Çështje dhe shqetësime	Përzgjedhja e aktiviteteve 3R	
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								

4.3 Vizita individuale në bashki për mbështetje

Për bashkitë të cilat kanë një vlerësim më pak se 3 sipas mënyrës së përmëndur më sipër, synohen që të vizitohen të parat, ndërkohë ato që kanë një vlerësim 4 ose 5 gjithashtu do të mbështeten nëse kanë nëonje pjesë të paplotësuar.

- **Përmbajtja e mbështetjes individuale**

Gjatë vizitës në bashki, mbështetja për të plotësuar pjesët e paplotësuara është dhënë në metodat e mëposhtme;

Duke i dhënë shpjegim të qartë dhe të plotë meth plotësimit të informacionit dhe duke i lejuar zyrën bashkiake për ta përfunduar.

Kur zyrtarët bashkiak nuk kanë informacionin e nevojshëm, kërkojnë informacion nga stafet e tyre në terren ose zekonoet perbashtë e te bashkisë.

Kërkim për informacion në faqe interneti.

4.4 Gjendja e tanishme e MMN për bashkitë vendore në të gjithë Shqipërinë është verifikuar duke formuluar Planin e Veprimit 3R dhe përdorimi e saj

Gjendja aktuale e MMN e sqaruar për të formuluar PV-3R për bashkitë të gjithë Shqipërinë përmes seminarit, ndjekja dhe vizita individuale, është bartur dhe përdorur për përmirësimin e MMN dhe promovimin e 3R-ve.

4.4.1 Kushtet e tanishme të MMN

Pikat dhe metoda e llogaritjes që tregon kushtet e tanishme të MMN përmbidhen në Tabelën 4-2 dhe informacionet dhe të dhënat e grumbulluara në Tabelën 4-3.

Tabela 4-2 Përmbajtja për identifikimin e kushteve të tanishme të MMN

Pikat	Përmbajtja/Përcaktimi/Metoda e llogaritjes
Sektori që ofron shërbimin e grumbullimit	NjQV / Kompani private grumbullimi / NjQV + privat / Të tjerë
Llojі i vendodepozitimit	A. Landfill me impiant sanitar / B. Vendodepozitim pa impiant sanitar / C. Vend i paminituar
Sasia e prodhuar e mbetjeve (ton/dite)	Sasia e prodhuar e mbetjeve (Sasia e prodhuar e mbetjeve nga familjet + Sasia e prodhuar e mbetjeve nga bizneset dhe pastrimi publik) dhe sasia e grumbulluar e mbetjeve që llogaritet nga programi i rrymës së mbetjeve i zhvilluar në Udhëtrëfyesin 3R.
Sasia e prodhuar e mbetjeve për person (gjiperson/dite)	Vlera e njëmë nga sasia e prodhuar e mbetjeve (lreguar më sipër) nga popullsia, që tregon sasinë e prodhuar të mbetjeve nga 1 person në 1 ditë.
Norma e grumbullimit të mbetjeve (%)	Nëpërmjet NSSWM, janë njëmë norma e grumbullimit të mbetjeve të territorit të vjetër. Bazuar në këto të dhëna, janë llogaritur raporti i grumbullimit të mbetjeve të NjA dhe gjithë NjQV-se.
Norma e riciklimit (%)	Raporti i sasisë së ricikluar tek sasia e prodhuar e mbetjeve është llogaritur nga programi i rrymës së mbetjeve. "Norma e riciklimit" është shuma e normës së riciklimit në burimin e prodhimit të mbetjeve, në pikën e zbrazjes dhe vendodepozitimin përfundimtar.
Norma e depozitimit përfundimtar (%)	Norma e depozitimit përfundimtar llogaritet nga ndarja e sasisë depozitimit përfundimtar nga sasia e prodhuar e mbetjeve.

Tabela 4-3 Shënimet informacioni dhe të dhëna të nxjerra nga Plani Veprimit 3R

JR	Popullsia m. 2012	Sektori që ofron shërbimin e grumbullimit	Tipi vendodepozitimit	Sasia e prodhuar e mbetjeve	Sasia e grumbullimit e mbetjeve	Raporti prodhuar ndaj JMD	Raporti grumbullimit ndaj JMD	Mbulimi i grumbullimit i mbetjeve	Raporti riciklimit	Raporti depozitimit
				ton/dite	ton/dite	g/person	g/person	%	%	%
1	30,100	Bashkia	B	20.52	24.20	775	914	85	11.2	81.8
2	4,700	Bashkia	C	3.78	0.62	301	174	36	16.4	43.0
3	3,400	Bashkia	B	3.07	1.00	330	301	40	9.4	90.6
4	35,600	Bashkia	B	9.95	5.90	255	345	71	9.9	62.3
5	9,400	Bashkia	B	3.62	4.64	387	494	65	7.9	63.0
6	34,300	-	-	6.12	1.41	432	100	26	23.2	23.0
7	6,100	-	-	4.38	2.77	352	242	38	9.5	64.0
8	26,900	Bashkia Bashkia	A	23.26	19.62	865	729	85	10.7	65.5
9	13,800	Bashkia	A	3.17	4.24	479	413	100	12.4	90.0
10	19,900	-	B	3.25	2.36	301	219	73	18.5	62.5
11	31,200	Bashkia	A	4.37	2.65	466	272	90	3.9	86.5
12	159,400	Bashkia	B	110.75	90.65	694	568	81	19.4	60.0
13	21,000	-	B	8.50	3.50	404	167	34	10.4	37.4
14	16,200	-	-	3.52	1.20	217	117	37	9.9	20.3
15	180,000	Privat Bashkia	B	100.42	90.93	558	505	91	12.5	90.5
16	36,900	Privat Bashkia	B	17.37	11.21	471	304	65	11.4	64.5
17	30,600	Bashkia	B	23.30	19.66	761	643	84	11.4	84.0
18	26,900	Bashkia	B	13.12	10.89	487	405	83	12.1	81.6
19	111,400	Bashkia	B	63.96	49.62	574	446	78	12.7	77.6
20	45,300	Bashkia	B	21.24	13.03	467	288	61	12.2	73.6
21	79,600	-	-	37.97	47.65	726	598	84	11.8	81.3
22	41,600	Bashkia	B	21.94	20.42	527	491	77	10.2	74.3
23	36,200	Bashkia	B	17.14	12.12	473	335	70	12.8	72.3
24	24,300	-	-	7.58	4.10	311	169	42	10.1	34.3
25	35,600	Bashkia	B	8.28	4.20	233	118	42	10.4	31.7
26	180,400	Privat Bashkia	A	126.00	108.73	698	603	83	11.8	84.0
27	34,700	-	-	7.28	4.04	210	116	45	11.2	43.0
28	9,800	-	-	4.98	3.17	508	323	63	10.7	46.5
29	45,300	Bashkia	A	30.94	23.62	683	521	77	11.6	71.2
30	41,100	-	-	17.61	6.46	428	158	37	13.6	36.8
31	87,300	Bashkia	A	44.96	31.65	515	363	74	13.7	69.0
32	28,400	Bashkia	B	17.13	13.10	603	461	76	7.2	75.4
33	61,000	-	-	47.66	21.77	777	357	46	7.7	42.0
34	195,300	Bashkia	A(ambil B)	131.12	104.66	671	536	80	13.6	79.0
35	36,300	Bashkia	B	21.98	17.61	605	485	80	10.9	79.9
36	31,600	Bashkia	B	13.94	11.59	441	367	83	9.7	83.0
37	31,300	Privat Bashkia	B	16.12	8.20	515	262	51	10.6	38.4
38	24,000	-	-	11.32	8.07	472	336	41	12.2	67.5
39	42,300	Bashkia	B	18.40	7.03	435	166	34	12.2	40.0
40	34,700	Bashkia	B	16.12	12.12	465	349	81	12.5	74.5

A Vendëpozitim shëtitës sanitar

B Vendëpozitim sipërmarrës pa shëtitës sanitar

C Vendëpozitim i paqëruar

4.4.2 Kushtet e tanishme financiare në MMN

Me qëllim lopimin e gjendjes së tanishme të MMN, financat janë faktori me i rëndësishëm i MMN. Pikat dhe metodat e llogaritjes së kushteve të tanishme financiare të MMN përmbidhen në Tabelën 4-4. Të dhënat e grumbulluara dhe treguesit përmbidhen në Tabelë 4-5.

Tabela 4-4 Përmbajtja e kushteve të tanishme financiare mbi MMN

Pikat	Përcaktime dhe metoda e llogaritjes
Të dhëna financiare lidhur me MMN	Është e vështirë të përcaktohen të dhënat financiare për 2015 dhe 2016 pasi ka qenë periudhë tranzicioni e reformës territoriale. Rekomandohet që të dhënat financiare të organizohen bazuar në llogaritë e kaluara.
Buxheti gjithsej i NjQV-së	
Kosto e MMN	Shuma e gjithë llojeve të shpenzimeve për MMN. (grumbullimi, trajtimi i ndërmjetëm, depozitimi përfundimtar, pastrimi publik, menaxhimi i makinerive, kosto punës, kosto të tjera menaxhimi etj.)
Tarifa e mbetjeve (Familja)	Norma e tarifës së mbetjeve (tarifa e grumbullimit dhe pastrimit) e ndarë sipas kategorive; familje ose biznese. Ka ndryshime ndërmjet biznesave sipas madhësisë. Këtu është marrë parasysh vetëm tarifa për familjet.
Grumbullimi i tarifës së mbetjeve	Mbledhja e tarifës së grumbullimit të mbetjeve në 1 vit
Norma grumbullimit tarifës së mbetjeve	Norma e grumbullimit të tarifës së mbetjeve

Treguesit e mëposhtëm për vlerësimin e kushteve të tanishme të MMN janë njëmë nga të dhënat financiare dhe sasia e grumbulluar e mbetjeve.

- ☐ Kosto e menaxhimit të mbetjeve për njësinë e grumbulluar të mbetjeve (lekë/ton) = (Kosto vjetore e MMNB) / (Bazinë vjetore të mbetjeve të grumbulluara)
- ☐ Norma e kostoz vjetore për MMNB në buxhetin vjetor të NjQV-se (%) = (Kosto vjetore e MMNB) / (Buxhetin vjetor të NjQV-së)*100%
- ☐ Përqindja e mbledhur e tarifës së mbetjeve në mbulon koston vjetore të menaxhimit të mbetjeve (%) = (Tarifa e mbledhur e mbetjeve) / (Koston vjetore të menaxhimit të mbetjeve)*100%



Tabela 4-5 Shembulli i të rënëve financiare dhe frequest e MMN të dala nga Plani Veprimit 3R

5 Kosto për mbështetje për formulimin e Plan Veprimit 3R

Kosto totale për mbështetje për formulimin e PV-3R duke synuar të gjitha bashkitë me 12 Qarqe vlerësohet në jetë 1.50 million lekë bazuar në koston e transportit, shtesave dërse dhe akomodimi, per dërfenu dhe asistentin, si dhe tarifa e qerasë per 7 copë kompjutera, pëlhëshë ndjekjes dhe vënë ipërvënë ne 7 Qarqe

6.3.2 Udhëzime për rinovimin dhe rishikimin e Udhërrëfyesit 3R

Pas udhëzimit për të mbështetur formulimin e Plan Veprimit 3R, u ofrua gjithashtu udhëzim për përditësimin dhe rishikimin e Udhërrëfyesit 3R. Aspektet e mëposhtme u shpjeguan:

- Përditësimi dhe rishikimi i Udhërrëfyesit 3R duhet të bazohet në informacionin e ofruar nga NjQV-ja për MM.
- Informacioni nga NjQV-ja duhet të grumbullohet sipas formatit që do të dërgohen dhe grumbullohen nëpër qarqe nga MM. Nëpërmjet këtij procesi, qarqet pritet të bëhen të vetëdijshëm për aktivitetet e NjQV-ve.
- Përditësimi i Udhërrëfyesit 3R duhet të bëhet çdo vit, duke shtuar praktikat e mira dhe aktivitetet e reja, të cilat nuk janë të përfshira ose ndryshojnë nga Udhërrëfyesi 3R i tanishëm, bazuar në informacionin e ofruar nga NjQV-ja.
- Rishikimi i Udhërrëfyesit 3R duhet të bëhet një herë në pesë vjet. Bazuar në informacionin e NjQV-ve të mbledhur në pesë vitet e fundit, “lista e aktiviteteve 3R dhe teknologjitë” Udhërrëfyesi duhet të rishikohet për të përfshirë aktivitetet 3R të cilat do zbatohen momentalisht dhe konsiderohen më të realizueshme në Shqipëri.
- Udhërrëfyesi 3R është bazuar në Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta dhe Plan Veprimin Kombëtar. Prandaj, kur njëri prej tyre është rishikuar, pjesët përkatëse në Udhërrëfyesin 3R duhen rishikuar përkatësisht.

Prezantimi i përdorur në udhëzim tregohet më poshtë.

Përditësim dhe Rishikim për Udhërrëfyesin 3R

Shkurt 2017
Ekipi i Ekspertëve të JICA

1. Roli i MM

- Roli i MM është përcaktuar që "MM duhet të mbështesë dhe promovojë menaxhimin e mbetjeve në nivel Kombëtar.
- Aktivitetet 3R janë një nga menaxhimi i mbetjeve, pra, MM është e detyruar për të mbështetur dhe për të promovuar aktivitetet 3R.

2. Si të mbështesni dhe monitoroni

- Përpara mbështetjes dhe promovimit të aktiviteteve 3R, MM duhet të kapë aktivitetet e tanishme 3R në nivel njësie qeverisje vendore.
- Rekomandohet vizitimi i të gjitha njësive të qeverisjes vendore nga MM.
- Megjithatë nuk është realiste për t'u vizituar 61 bashki nga MM.
- MM duhet të kapë gjendjen e tanishme duke ndjekur fletën e monitorimit.

3. Fleta e monitorimit

Emri i Bashkisë		
Emri i Oficerit të kontrollitur		
Data e Raportit:		
Paraqitjet		
1	Drafti Plan Veprimi 3R në përgatitje	Data e publikimit: Për vitin deri (plan 5 vjeçar)
2	Drafti është përgatitur. Duke pritur miratimin e këshillit bashkiak	Data e miratimit:
3	Miratuar nga Këshilli bashkiak. Duke pritur për ndarjen e buxhetit per zbatimin e aktiviteteve.	Data e ndarjes së buxhetit:
4	Ecuria e Aktiviteti 3R	
(1)	Emri i Aktivitetit	Ecuria: Problemet e hasura:
(2)	Emri i Aktivitetit	Ecuria: Problemet e hasura:
(3)	Emri i Aktivitetit	Ecuria: Problemet e hasura:

Ju lutemi lëreni ne fushën e poshtme Aktivitetin e fundit (i kompleksuar, i cili ju çon ne formalizim e suksesshme apo shqetësuan procesin e formalizimit te Plan Veprimit 3R per bashkinë tuaj):

4. Dërgimi dhe korrigjimi



5. Përditësimi i Udhërrëfyesit 3R

- MM përzgjedh informacion aktivitetesh ose aktivitete të përmirësuara të cilat nuk përmbahen në Udhërrëfyesin 3R.
- MM duhet të përmbledhë pikat e aktiviteteve të detajuara, përmirësimin dhe efektivitetin dhe t'ia bëjë me dije publikut.
- MM duhet të shtojë këto përmbajtje në "8.2 Prezantimi i aktiviteteve 3R" në Udhërrëfyesin 3R.
- Ai duhet të kryhet një herë në pesë vjet.

6. Rishikimi i Udhërrëfyesit 3R

- Udhërrëfyesi 3R është formuluar në bazë të strategjisë Kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe plan veprimit Kombëtar të menaxhimit të mbetjeve.
- Që nga Janari 2017, strategjia Kombëtare për menaxhimin e mbetjeve është duke planifikuar për t'u rishikuar nga GIZ.
- MM duhet të shqyrtojë përmbajtjen e Udhërrëfyesit 3R në përputhje me ta.
- Gjithashtu, MM duhet të shqyrtojë Udhërrëfyesin 3R bazuar në informacionin e përfshirë "Praktikë e mirë" dhe "Aktivitete të reja" të dhëna nga njësitë e Qeverisjes Vendore.
- Ai duhet të kryhet një herë në pesë vjet.

6.4 Marrëdhëniet me Publikun

A Buletini

A.1 Përmbledhje e publikimit

	Çështja	Nr. 1			Nr. 2		Nr. 3		Nr. 4		Nr. 5	
	Koha e lëshimit	Prill 2015			Shkurt 2016		Nëntor 2016		Shkurt 2017		Maj 2017	
Shpërndarja	Gjuha	Shq	Ang	Poster	Shq	Ang	Shq	Ang	Shq	Ang	Shq	Ang
(1)Bashki	Tirana	1,100	0	12	1,200	0	720	0	720	0	720	0
	Vau i Dejës	500	0	3	500	0	500	0	500	0	500	0
	Cërrik	100	0	3	500	0	500	0	500	0	500	0
(2)Qeveria Qendrore	MM	50	0	2	50	0	50	0	50	0	50	0
	MTI	50	0	2	50	0	50	0	50	0	50	0
	MZHU&I	50	0	2	50	0	50	0	50	0	50	0
(3)Pala Japoneze	JICA	50	50	2	50	50	50	50	50	50	50	50
	EEJ	50	50	0	50	50	80	50	80	50	80	50
Totali		1,950	100	26	2,450	100	2,000	100	2,000	100	2,000	100

A.2 Nr. 1

PROJEKTI MBËSHTETJE PËR MINIMIZIMIN E MBETJEVE DHE PROMOVIMIN E 3R-VE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Buletini Nr.1
Prill 2015

*Ministria e Mjedisit (MM) dhe njësitë e pushtetit vendor kanë nisur **Projektin Mbështetje për Minimizimin e Mbetjeve dhe Promovimin e 3R-ve në Republikën e Shqipërisë ("Projekti")** nën bashkëpunimin teknik të Agjensisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA). Projekti do të vazhdoj për 3 vjet duke filluar nga Qershori 2014. Ky buletin i parë prezanton një përmbledhje të Projektit si dhe aktivitetet që janë zhvilluar deri tani.*

Historiku: Republika e Shqipërisë është përballur me urbanizim të shpejtë gjatë viteve të fundit. Një rritje e konsiderueshme e popullatës e ka shumëfishuar sasinë e mbetjeve të gjeneruara, e cila ka patur një ndikim negativ në mjedisin e jetesës. Në këtë situatë, roli dhe politikat e qeverive vendore në menaxhimin e mbetjeve të ngurta kanë qenë gjithmonë e më të rëndësishëme që të përballojnë në mënyrën e duhur numrin gjithnjë e në rritje të mbetjeve si dhe për të patur një shoqëri të qëndrueshme për mjedisin.

Ndërkohë, me qëllim që të jetë një shtet anëtar i Bashkimit Evropian, qeveria Shqiptare ka përcaktuar politikat kombëtare mjedisore në përputhje me direktivat e BE-së. Po ashtu, në fushën e menaxhimit të mbetjeve, Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve në Shqipëri është formuluar duke vendosur si qëllim zvogëlimin e mbetjeve me 25% më pak në vitin 2015, 35% më pak në vitin 2016, dhe 55% më pak në vitin 2020 duke patur si vit bazë 1995, që është pikërisht i njëjtë me qëllimin e përcaktuar nga BE-ja.

Për të arritur këtë qëllim, është e nevojshme që njësitë kombëtare dhe vendore të qeverisë të përfshijnë konceptin e "Reduktimit" "Ripërdorimit" dhe "Riciklimit", (në vazhdim referuar si "3R") në skemën e menaxhimit të mbetjeve në mënyrë që të pakësohen mbetjet dhe për të përfituar sa më shumë që të jetë e mundur nga burimet natyrore.

Në këtë kuadër, qeveria e Shqipërisë i ka kërkuar qeverisë së Japonisë ti mundësoj asistencë teknike për përmirësimin e çështjeve të menaxhimit të mbetjeve. Sipas kësaj kërkese Agjensia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) ka kryer një studim në terren për të kuptuar nevojat e Shqipërisë, duke vendosur përfundimisht **"Projektin Mbështetje për Minimizimin e Mbetjve dhe Promovimin e 3R-ve në Republikën e Shqipërsië"** në bazë të skemës së bashkëpunimit teknik. Në Janar 2014, Procesverbali i Diskutimit, u nënshkrua reciprokisht nga qeveria e Shqipërisë dhe Japonisë dhe Projekti filloi në Qershor 2014.

1. Përshkrimi i Projektit

Projekti implementohet nën skemën e bashkëpunimit teknik që synon 'transferimin e teknologjisë' nga ekspertët japonezë për personelin homolog shqiptarë. JICA pret që kapaciteti i homologëve, bashkive dhe organizatave për menaxhimin e mbetjeve të ngurta të forcohet përmes këtij transferimi të teknologjisë. **Ministria e Mjedisit (MM)** është përcaktuar të jetë homologu dhe përgjegjësi kryesor në këtë Projekt.

Qëllimi i përgjithshëm: Korniza 3R prezantohet në menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve të ngurta (MMN) në qeveritë vendore në Shqipëri për pakësim te mbetjeve, si një përpjekje mbarëkombëtare.

Qëllimi i Projektit: Kapaciteti i Ministrisë së Mjedisit (MM) do të forcohet në aspektin e zhvillimeve të politikave 3R dhe sigurimin e mbështetjes për qeveritë vendore me qëllim zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planin e Veprimit në Shqipëri.

Outpute: Gjashtë outpute (përfundime) si më poshtë priten të arrihen gjatë Projektit.

Output 1:
Statusi i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta(MMN) dhe sfidat për të prezantuar 3R në MMN në secilën qeveri vendore janë identifikuar nga Ministria e Mjedisit.

Output 2:
Krijimi i Udhëzuesit për prezantim të 3R-ve në planin rajonal të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta (Udhëzuesi 3R).

Output 3:
Realizimi i Projektit Pilot për praktikat 3R në MMN në shkallë të vogël në qeveritë vendore (Komuna Bushat) dhe identifikimi i sfidave të tij.

Output 4:
Realizimi i Projektit Pilot për praktikat 3R në MMN në shkallë të mesme në qeveritë vendore (Bashkia Cerrik) dhe identifikimi i sfidave të tij.

Output 5:
Realizimi i Projektit Pilot për praktikat 3R në MMN në shkallë të madhe në qeveritë vendore (Bashkia Tiranë) dhe identifikimi i sfidave të tij.

Output 6:
Forcimi i asistencës dhe bashkepunimit mes Ministrisë së Mjedisit me qeverive vendore për praktikat 3R në Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta.

Kohëzgjatja e Projektit: Qershor 2014- 2017 Maj (3 vjet)

Zona e Synuar: Projekti synon bashkinë e Tiranës, bashkinë e Cërrikut and komunën Bushat.

Mbetjet e Synuara: Termi "Mbetjet" në këtë Projekt i referohet mbetjeve bashkiake të grumbulluara nga familjet dhe subjektet e biznesit. Mbetjet industriale dhe spitalore janë të përjashtuara.

Administrimi i Projektit: Projekti drejtohet bashkarisht nga homologët shqiptarë dhe ekspertët e dërguar nga JICA. Për më tepër, Komiteti i Përbashkët Koordinues (KPK) është themeluar për të monitoruar/vlerësuar ecurinë e Projektit. Në vijim jepet lista e homologëve dhe Ekspertëve Japonezë.

1) Homologët Kryesor:
Pozicionet në Projekt, emrat dhe postet, mbajtur në Korrik 2014.

- *Drejtor Projekti* :
  Z. Pëllumb ABESHI, Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Mjedisore, Ministria e Mjedisit
- *Menaxher Projekti* :
  Z. Redi BADUNI, Drejtor i Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Mjedisore, Ministria e Mjedisit
- *Ekspertët për zhvillimin e Udhëzuesit 3R*:
  Z. Vladimir BEZHANI, Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Aksidenteve Industriale, Ministria e Mjedisit
- *Administrativ dhe Koordinim* :
  Znj. Ledjana KARALLIU, Specialiste në Sektorin e Menaxhimit të Mbetjeve dhe Aksidenteve Industriale, Ministria e Mjedisit
- *Bashkëpunëtor*:
  Z. Isa MEMIA, Specialist pranë Drejtorisë së Politikave të Mbetjeve të Ngurta, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

2) Ekipi i Ekspertëve JICA
Ekspertët e dërguar nga JICA të Kokusai Kogyo Co., Ltd në Japoni. Emrat dhe pozicionet jepen si më poshtë.

- *Këshilltar Kryesor/ Menaxhim i Integruar i Mbetjeve të Ngurta*:
  Z. Hiroshi FUJITA
- *Zv. Këshilltare Kryesore/ Ndërgjegjësimi publik dhe Edukimi mjedisor*:
  Znj. Chiaki NISHI
- *Politika dhe Praktika 3R*:
  Z. Koji KUSUNOKI
- *Masat dhe Politika Administrative*:
  Z. Shinnosuke ODA
- *Qasja Pjesërarrëse në Praktikat 3R*:
  Znj. Aya ITO
- *Koordinatore*:
  Znj. Maiko FUKUTOMI

3) Komiteti i Përbashkët Koordinues (KPK)

Në Korrik 2014, Z. ABESHI, Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Mjedisore, MM, hapi mbledhjen e parë të KPK. Gjatë këtij takimi, Këshilltari Kryesor, Z. FUJITA, i Ekipit të Ekspertëve të JICA (në vazhdim, EEJ), prezantoi Planin e Punës pjesëmarrësve nga Ministritë dhe njësive vendore të caktuara si zona të projektit pilot. U shpjegua plani i propozuar dhe shtrirja kohore e projektit i cili u miratua zyrtarisht nga pjesëmarrësit.

KPK I parë në Korrik 2014

2. Aktivitete të kryera gjatë Projektit

1) Studimi i Sasisë dhe Përbërjes së Mbetjeve (SSPM) : Tetor 2014

SSPM u realizua në bashkinë Lezhë dhe komunën Bushat në Tetor 2014. Gjatë studimit, kampione të mbetjeve u mblodhën nga familjet me mbështetjen e kompanive të grumbullimit të mbetjeve dhe njësive vendore. Përsa i përket bashkisë Tiranë, SSPM nuk u krye këtë here duke marrë në konsideratë të dhënat e disponueshme nga një studim i realizuar në vitin 2011. Në bazë të të dhënave të disponueshme, sasia e tanishme e mbetjeve në bashkinë e Tiranës është llogaritur duke marrë parasysh normën e rritjes së GDP kombëtare dhe variablave të tjera demografike.

Numri i familjeve dhe periudha e studimit

Njësia Vendore	Nr. i familjeve	Periudha e Studimit
Tiranë	100	2011
Lezhë	30	18 – 24 Tetor 2014
Bushat	30	7 - 13 Tetor 2014

Qëllimi i SSPM:

SSPM është një nga studimet më të rendësishme për të kuptuar e vlerësuar normën e gjenerimit të mbetjeve në burim, të tillë si familje, dhe për të identifikuar gjëndjen fizike të mbetjeve. Të dhënat e mbledhura nga SSPM përdoren për të krijuar rrymën e mbetjeve bashkiake e cila tregon proçesin që mbetjet kalojnë përpara se të depozitohen në venddepozitimet përfundimare dhe sasinë e gjeneruar të mbetjeve në çdo fazë. Në këtë mënyrë, krijmi i rrymës së mbetjeve jep një pasqyrë të qartë të rrjedhës së tanishme të mbetjeve në qytet, dhe gjithashtu do të jetë një bazë për të formuluar një plan të ardhshëm të menaxhimit të mbetjeve si dhe politikën 3R.

Metodologjia e SSPM:

SSPM përbëhet nga 2 pjesë: Studimi i Sasisë së Mbetjeve (SSM) and Studim i Përbërjes së Mbetjeve (SPM).

SSM: Mbetjet e ndara në organike dhe jo organike u mblodhën nga familjet për 7 ditë rresht. Të gjitha mbetjet e grumbulluara u peshuan dhe u regjistruan për çdo shtëpi. Në përfundim, raporti i gjenerimit të mbetjeve nga familjet është llogaritur duke përdorur të dhënat e mbledhura.

SPM: Të gjitha kampionet e mbetjeve të grumbulluara u ndanë në 16 lloje: mbetje kuzhine, karton, lëtër tjetër, shishe PET, plastik e rëndë, plastik tjetër, hekur, alumin, metal tjetër, qelq, bar/dru, tekstile, gome / lëkure, qeramikë/ gurë, pelena, dhe tjetër. Me anë të këtij proçesi, u identifikua përbërja fizike e mbetjeve.

Rezultati I SSM :

Rezultati i SSM jepet më poshtë. Është interesant fakti se, nuk kishte dallim të madh në shumën e gjenerimit mbetjeve midis 3 njësive. Por, studimi zbuloi se në zonat e urbanizuara ka tendencë për të gjeneruar më shumë mbetje si: 373g në Tiranë, 361g në Lezhë, dhe 331g në Bushat.

Sasia e gjeneruar e mbetjeve në burim për banor / ditë

Njësia Vendore	Mbetje Organike	Mbetje jo organike	Totali
Tiranë	172g	201g	373g
Lezhë	221g	140g	361g
Bushat	230g	101g	331g

Peshimi i kampioneve te mbetejve

Rezultati i SPM:

Në çdo njësi vendore mbetjet e kuzhinës përbejnë pjesën më të madhe në raportin e përbërjes së mbetjeve. Kjo karakteristikë bëhet

më i spikatur në zonat më pak të urbanizuara, si komuna Bushat. Përqindja e mbetjeve të ricikluesshme (karton, shishe PET, plastik e rëndë, hekur dhe alumin) ka tendencë të jetë më e lartë në zonat e urbanizuara, si bashkia e Tiranës.

Përbërja fizike e mbetjeve

Përbërja	Bashkia Tiranë	Bashkia Lezhë	Komuna Bushat
1. Mbetje kuzhine	46.21%	61.30%	69.41%
2. Karton	5.28%	2.30%	2.74%
3. Letër tjetër	8.98%	3.20%	2.43%
4. Shishe PET	5.02%	2.90%	1.16%
5. Plastikë e rëndë	3.09%	2.70%	2.32%
6. Plastik tjetër	9.20%	6.30%	5.18%
7.Hekur	0.87%	0.60%	0.12%
8. Alumin	0.49%	0.90%	0.83%
9. Metal tjetër	0.80%	0.00%	0.40%
10. Qelq	3.40%	8.00%	6.83%
11.Bar/Dru	4.10%	2.70%	1.60%
12.Tekstil	3.15%	4.10%	1.56%
13 Gomë/Lëkurë	1.41%	1.70%	0.22%
14. Qeramik/Gurë	1.96%	0.50%	0.02%
15. Pelena	5.53%	2.60%	3.94%
16. Tjetër	0.70%	0.20%	1.25%
Totali	100.00%	100.00%	100.01%
Të ricikluesshme	14.80%	9.40%	7.20%

Ndarja e mbetjeve në 16 kategori

2) Studimi për materialet e ricikluesshme: Shtator– Nëntor /2014

Qëllimi I Studimit:
Me qëllim për të vlerësuar sasinë e materialeve të ricikluesshme të gjeneruara në burim, studimi për materialet e ricikluesshme u krye në Tiranë dhe në bashki të tjera (Korçë, Vlorë, dhe Shkodër) gjatë periudhës Shtator-Nëntor 2014. Të dhënat e mbledhura nga ky studim do të përdoren për të krijuar rrymën kombëtare të materialeve të ricikluesshme në Shqipëri.

Përshkrimi I Studimit: Studimi u krye në katër bashki duke intervistuar kompanitë e grumbullimit të materialeve të ricikluesshme.

Rezultati i Studimit:. Midis katër bashkive, u vu re pak ndryshim në shumë totale të grumbullimit duke përjashtuar skrepin e makinave e cila kategorizohet si mbetje industriale. Përsa i përket përbërjes së mbetjeve të ricikluesshme, kartoni, plastika e lehtë, metali dhe shishet PET kanë qenë materialet kryesore të mbledhura në katër qytetet.

Sasia e grumbulluar e materialeve të ricikluesshme

Lloji		Njësia	Mesatarja e njësive të tjera	Bshkia Tirane
Letër		t /ditë	0	0.7
Alumin			0	1.2
Karton			3.2	4.3
Plastik e rendë			0.8	5.6
Shishe PET			1.9	17.4
Plastik tjetër			3.6	29.1
Metal			1.8	6.5
Metal nga skrepi i makinave			8.4	29.7
Totali		t /ditë	19.7	94.5
Sasina e materialeve të ricikluesshme të gjeneruara në burim,	Totali	g/frymë/ditë (*)	214	170
	Totali duke përjashtuar skrepin e makinave		123	117

(*) popullsia e Tiranës: 556,600 / Qytetet e tjera: 92,100 (Tabelë Tentative)

4.Përmbledhje
Ky bulletin i parë ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të situatës aktuale të mbetjeve urbane në Shqipëri duke prezantuar rezultatet e SSPM dhe Studimit për materialet e ricikluesshme. Buletini i ardhshëm do të përmbajë më shumë informacion për menaxhimin e mbetjeve në nivel kombëtar dhe opinionit publik për çështjet e mbetjeve / riciklimit nga studimet tona të vazhdueshme.

PËR KONTAKT
Ekspertët e JICA (Kontakt në Anglisht)
-Z. Hiroshi FUJITA, Këshiltari Kryesor
-Znj. Chiaki NISHI, Zv. Këshilltare Kryesore

Asistentë Projekti (Kontakt në Anglisht dhe Shqip)
-Z. Kreshnik BAJRAKTARI: Mob. 069 74 46 975
-Znjsh. Ela MUKA: Mob. 069 53 07 653

Adresa e Zyrës:
Rr. Luigj Gurakuqi, Pallati Albsig, Shkalla 1, Kati 1, Nr.11, Tiranë, Shqipëri

A.3 Nr. 2

PROJEKTI MBËSHTETJE PËR MINIMIZIMIN E MBETJEVE DHE PROMOVIMIN E 3R-VE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Buletini Nr.2 Shkurt 2016

MINISTRIA E MJEDISIT

*Ka kaluar një vit e gjysëm që prej fillimit të **Projektit Mbështetje për Minimizinim e Mbetjeve dhe Promovimin e 3R-ve në Republikën e Shqipërisë ("Projekti")** në Korrik 2014. Edhe pse ka hasur me reformën territoriale administrative dhe zgjedhjet për pushtetin vendor gjatë verës të 2015, Projekti ka vazhduar me hartimin e Projekteve Pilote për 3 bashki, respektivisht, për Vaun e Dejës, Cërrikut dhe Tiranës. Ky Buletin prezanton përmbledhjen e këtyre Projekteve Pilot dhe aktiviteteve të zhvilluara deri më tani.*

PROJEKTET PILOT NË 3 BASHKI

Bashkia Vau i Dejës	
Zona e synuar	I gjithë territori i ish Komunës Bushat
Popullsia e synuar	14 fshatra: rreth 4,600 familje / me 300 kontenierë mbetjesh
Faza 1	
Çështjet	Mbetjet janë të shpërndara rreth pikave të zbrazjes (pranë kontenierëve), pjesërisht për shkak të shërbimit të çrregullt të ofruar të grumbullimit të mbetjeve si rezultat i çështjeve buxhetore.
Qëllimi	Të gjej koston për një shërbim më efikas dhe të besueshëm të grumbullimit të mbetjeve.
Përmbledhje e aktiviteteve	Me vendosjen e një itinerari të ri e më efiçent, dhe të një orari të rregullt të ofrimit të grumbullimit, synohet gjetja e efikasitetit të kostos dhe grumbullimit në bazë të procesverbalit të mbajtur gjatë zbatimit të grumbullimit të mbetjeve, e cila mund të përdoret për hartimin e dokumentit të aplikimit të buxhetit për menaxhimin e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve me kostot e vetë bashkisë nga viti 2016.
Faza 2	
Çështjet	Mënyra e papërshtatshme e zbrazjes nga ana e banorëve ka ulur efiçencën e shërbimit të grumbullimit. Veçanërisht, problem më serioz janë mbetjet e përgjithshme të përhapura në tokë të cilat nuk zbrazen brënda në kontenier, dhe gjithashtu sasitë e mëdha të mbetjeve bujqësore të zbrazura pranë kontenierëve.
Qëllimi	· Pikat e zbrazjes të përcaktuara për mbetjet bujqësore do të vendosen kryesisht në vende problematike. (1) Banorët ndjekin mënyrën e zbrazjes për ndarjen e mbetjeve: (2) Mbetjet e përgjithshme zbrazen brenda kontenierëve, · Mbetjet bujqësore zbrazen në një vend të caktuar. · Për pasojë, përmirësohet efiçenca e grumbullimit të mbetjeve.

Përmbledhje e aktiviteteve	Në zona kampion të identifikuara, vendosen kontenier të mëdhenj caktuar vetëm për mbetje bujqësore, veç kontenierëve normal bashkiak. Programet e ndërgjegjësimit zhvillohen në formën e mbledhjeve me komunitetin për tu shpjeguar mënyrën e zbrazjes së ndarë të mbetjeve bujqësore.
Faza 3 (duke u studiuar detajet e hartimit)	
Çështjet	· Edhe pse mbetjet bujqësore përbëjnë një sasi të madhe të mbetjeve që grumbullohen, ato depozitohen pa u kompostuar. · Pjesa më e madhe e mbetjeve të ricikluesshme me vlerë, të tilla si kanaçet e aluminit, shishet PET, etj. transportohen direkt në landfill duke qënë se në zonë veprojnë shumë pak grumbullues të materialeve të ricikluesshme (jo si në Tiranë).
Qëllimi	· Mbetjet bujqësore mund të kompostohen "brënda oborrit" ose "jashtë oborrit". · "Ndarja në burim" e mbetjeve të ricikluesshme me vlerë zhvillohet në vende që gjenerojnë sasi të mëdha, të tilla si baret dhe restorantet.

Bashkia Cërrik	
Faza1	
Zona e synuar	Një pjesë e Lagjes 3, në ish bashkinë Cërrik.
Popullsia e synuar	Rreth 100 familje që përdorin pikat e zbrazjes prej betoni anës rrugës.
Çështjet	· Në pikat e zbrazjes prej betoni, të vendosura përgjatë rrugës kryesore zbrazen dhe mbetje nga zona të tjera, të cilat shpeshherë hërpapen përreth këtyre pikave. · Gjithashtu gjenden mbetje bujqësore të përziera me mbetjet e tjera.
Qëllimi	<u>Përmirësimi i zbrazjes/grumbullimit</u> të mbetjeve urbane në zonën rurale për tu <u>përgatitur për grumbullimin e ndarë të materialeve të ricikluesshme.</u>
Përmbledhje e aktiviteteve	Shërbimi i grumbullimit derë më derë mundësohet me anë të një mjeti dhe muzikës që luhet në sfond me altoparlant, ("Grumbullim me sistem zanor"), ndërkohë që u prishën pikat e zbrazjes prej betoni. Përpara fillimit të shërbimit, familjet e synuara u informuan mbi rregullat e reja të zbrazjes nga stafi i bashkisë me anë të fletpalosjeve.

Faza 2	
Zona e synuar	E gjithë zona e ish bashkisë Cërrik
Popullsia e synuar	Rreth 14,500 banorë.
Çështjet	Si rezultat i mungesës së një venddepozitimi përfundimtar të përshtatshëm dhe kapacitetit të kufizuar të venddepozitimit të tanishëm, pakësimi i sasisë së depozituar të mbetjeve është një nevojë urgjente.
Qëllimi	Pakësimi i sasisë së mbetjeve nëpërmjet zbatimin të grumbullimit të ndarë të mbetjeve të ricikluesshme.
Përmbledhje e aktivitetit	Të ricikluesshmet (PET, plastikë, kanaçe alumini/çeliku, metale të tjera) do të grumbullohen të ndara nga mbetjet familjare jo të ricikluesshme, me anë të grumbullimit me sistem zanor sipas një programi, ndërkohë që mbetjet e tjera familjare jo të ricikluesshme do të vazhdojnë të zbrazen në kontenierët bashkiak dhe grumbullimi i tyre do të vazhdojë të jetë njësoj.

Bashkia Tiranë	
Zona e synuar	Zona e Laprakës dhe qëndra e qytetit
Çështjet	Ndarja e mbetjeve të ricikluesshme është provuar herë pas here, por nuk ka qënë e qëndrueshme, edhe në programe shkollore, ndërkohë që pakësimi i mbetjeve të depozituara është larg qëllimit të synuar në planin kombëtar. Shumë prej tyre kanë theksuar rëndësinë e ndërgjegjësimit, por nuk kanë arritur në një metodë të qëndrueshme.
Faza 1	
Popullisa e synuar	5 shkolla publike në zonën e Laprakës (rreth 4000 nxënës gjithësej) dhe 2 shkolla publike në qëndër të qytetit (rreth 2800 nxënës gjithsej)
Qëllimi	Nxënësit e shkollave do të familjarizohen me konceptin e ndarjes së mbetjeve të ricikluesshme dhe do të jenë ura lidhëse me komunitetin përreth.
Përmbledhje e aktivitetetit	Të ricikluesshmet e synuara të identifikuara nëpërmjet intervistave me ricikluesit aktiv në Bashkinë e Tiranës dhe që gjenerohen në shkolla do të zbrazen në mënyrë të ndarë nga nxënësit, dhe do tu dorëzohen ricikluesëve. Shkollat do të mbajnë të dhënat e aktiviteteve dhe do të raportojë për komunitetin, duke përfshirë prindërit dhe fqinjët e tyre.
Faza 2 (ende për tu përfunduar)	
Zona e synuar	Zona e Laprakës dhe qëndra e qytetit.
Popullsia e synuar	Për tu identifikuar nga komuniteti përreth shkollave të synuara në Fazën 1.
Qëllimi	Do të zhvillohet një mënyrë e qëndrueshme e grumbullimit të ndarë sipas kushteve të komunitetit të synuar me qëllim pakësimin e sasisë së mbetjeve që zbrazen në kontenierët bashkiak egzistues.
Përmbledhje e aktivitetit	Metodat e ndarjes dhe grumbullimit do të hartohen pas diskutimeve me komunitetin e synuar në mënyrë që të pasqyrojnë mendimet e tyre, përveç aktiviteteve ndërgjegjësuese.

TRAJNIMI I PARË I HOMOLOGËVE NË JAPONI

Projekti planifikon të zhvilloj trajnimin e homologëve në Japoni 3 herë gjatë periudhës 3 vjeçare të projektit. Trajnimi i parë u zhvillua në Maj 2015 për homologët në nivel ministror. Katër zyrtarë shqiptarë nga Ministria e Mjedisit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, dhe Ministria e Zhvillimit Urban morën pjesë në trajnimin 8 ditor që u zhvillua në bashkëpunim me bashkinë Ogaki në prefekturën Gifu në Japoni.



Pjesëmarrësit vizituan objekte të trajtimit të mbetjeve si dhe fabrika të riciklimit të plastikës, qelqit dhe mbetjeve voluminoze të grumbulluara nga shërbimi i ofruar nga bashkia. Ata vëzhguan nga afër se si një njësi vendore zbaton 3R nëpërmjet menaxhimit të mbetjeve të ngurta.

Zyrtarët e bashkisë Ogaki mirëpritën përzëmërsisht pjesëmarrësit, jo vetëm gjatë gjatë programeve zyrtare, por gjithashtu gjatë pushimeve të kafes dhe drekës. Pjesëmarrësit vizituan pjesën historike të Japonisë si dhe atmosferën metropolitane të qytetit të Nagoya ku qëndruan gjatë trajnimit.

I njëjti program trjanimi është parashikuar të mbahet në Maj 2016 – program pak më i gjatë, 2 javor- për zyrtarët bashkiak që zbatojnë projektin pilot në

bashkëpunim me stafin e projektit.

Takimi i dytë i KPK

Takimi i dytë i Komitetit të Përbashkët Koordinues (KPK) u zhvillua më 27 Janar 2016, në sallën e konferencës në Ministrinë e Mjedisit (MM), drejtuar nga Z. Pëllumb Abeshi, Drejtor i Përgjithshëm i Mjedisit dhe Drejtor i Projektit, për të konfirmuar hartimin e projekteve pilot që do të zbatohen dhe ndryshimet në Matricën e Hartimit të Projektit (MHP). Pjesëmarrësit ishin përfaqësues nga Zyra e Kryeministrisë, MM, MTI, MZHU, nga 3 bashkitë pilote respektivisht nga bashkia e Tiranës, Vau i Dejës dhe Cërrik. Takimit iu bashkua Z. Toshiya Abe, përfaqësues resident i zyrës së JICA në Ballkan shoqeruar nga zyrtarë të JICA.

Takimi u mbyll me fjalën e Z. Abe i cili theksoi rëndësinë e zotësimit të ministrive dhe njësive vendore në Projekt, si çelsi kryesor për zbatimin e suksesshëm, që është element kyç i zbatimit të suksesshëm të projektit për bashkëpunim teknik.

A.4 Nr. 3

PROJEKTI MBËSHTETJE PËR MINIMIZIMIN E MBETJEVE DHE PROMOVIMIN E 3R-VE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Buletini Nr.3 Nëntor 2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Projekti Mbështetje për Minimizimin e Mbetjeve dhe Promovimin e 3R-ve në Republikën e Shqipërisë ("Projekti") *po zbaton projektet e tij pilot (në vazhdim "PP") në tre bashki; përkatësisht në Bashkinë Vau i Dejës, Cërrik dhe Tiranë, siç është raportuar në numrin e kaluar të Buletinit. Kjo çështje flet për ecurinë e PP-ve për 6 muajt e fundit në secilën bashki, deri në Korrik 2016, dhe implikimet e tyre për Udhërrëfyesin 3R. Drafti i Udhërrëfyesit 3R pritet të përfundohet në fund të punës së Projektit në Shqipëri në Maj 2016.*
Trajnimi i dytë i homologëve dhe vizita në bashkinë Prizren për të marrë mësime nga shembujt e tyre, gjithashtu janë paraqitur.

Projekt Pilot në Bashkinë Vau i Dejës

Bashkia Vau i Dejës ka planifikuar të zbatojë PP në tre faza: Faza 1, përmirësimi i cilësisë dhe frekuencës së shërbimit të grumbullimit të mbetjeve; Faza 2, përmirësimi i mënyrës së zbrazjes së mbetjeve; dhe Faza 3, promovimi i riciklimit (kompostimi).

Gjatë Fazës 1, Projekti mbështeti bashkinë për të siguruar ofrimin e shërbimit të përshtatshëm të grumbullimit të mbetjeve. Shërbimet janë ofruar një herë në javë në të gjithë NjA Bushat duke përdorur kompaktorin e bashkisë. Nëpërmjet kësaj, pritej 1) për të arritur përmirësimin e efikasitetit të grumbullimit, 2) për të fituar mbështetjen e qytetarëve për shërbimin bashkiak, dhe 3) për të përmirësuar pamjen e qytetit duke pastruar mbetjet e shpërndara përreth kontejnerëve.

Bashkia ndërtoi besimin e qytetarëve për shërbimin e grumbullimit nëpërmjet Fazës 1 dhe u përgatit për zbatimin e aktiviteteve të Fazës 2. Në Fazën 2, banorët u inkurajuan për të zbrazur të ndara mbetjet e tyre bujqësore në një kontejner të projektuar posaçërisht, i cili u vendos në anë të kontejnerëve ekzistues të mbetjeve të përgjithshme në dy lagje pilote. Tani, banorët në këto lagje nuk zbrazin më mbetje bujqësore në tokë. Kjo ka ndihmuar bashkinë për të shkurtuar kohën e heqjes së grumbujve të mbetjeve nga toka, duke çuar në përmirësimin e efikasitetit të grumbullimit.

Mbetjet bujqësore zbrazen në kontejnerët e projektuar të ndara nga mbetjet e përgjithshme të cilat zbrazen në kontejnerin e vogël që shihet në të majtë.

Projekti tani është duke lëvizur për në Fazën 3, në të cilën është për qëllim të provojnë metodat e kompostimit. Gjithashtu është duke u diskutuar mundësia e përdorimit të mbetjeve bujqësore të zbrazura të ndara në kontejnerët e projektuar.

Një nga pikat pilot për PP2 <u>përpara</u> vendosjes së kontejnerit të madh të projektuar posaçërisht për mbetjet bujqësore.

E njëjta pikë si më sipër <u>pas</u> fillimit të aktivitetit të PP2 për të zbrazur të ndara mbetjet bujqësore.

Projekte Pilot në Bashkinë Cërrik

Në Cërrik, janë duke u zbatuar dy PP: 1) përmirësimi i zbrazjes dhe sistemit të grumbullimit në zonën rurale; dhe 2) sistem i ndarë grumbullimi për të ricikluesshmet nga burimet gjeneruese.

Në PP1, pritej përmirësimi i cilësisë së grumbullimit të mbetjeve dhe mënyra e zbrazjes nga banorët si dhe gjendja e mbetjeve të shpërhapura përreth pikave të zbrazjes së mbetjeve prej betoni që ekzistonin në zonën rurale, duke ofruar shërbim të

përpiktë të grumbullimit të mbetjeve. Bashkia hoqi strukturat e pikave të grumbullimit të cilat ekzistonin në zonën e synuar; i.e. Lagjja 3 (ose Ferma), dhe zbatoi grumbullimin derë më derë me një mjet grumbullimi duke ardhur në dyert e tyre në kohë të paracaktuar dhe duke njoftuar me një melodi të zgjedhur për këtë lloj grumbullimi. Me qëllim të informimit për orarin e grumbullimit dhe rregullat, bashkia përgatiti një fletëpalosje dhe e shpërndau atë në çdo shtëpi.

Banorët e zonës së synuar duket se janë të vetëdijshëm për kohën e grumbullimit, e cila i ka lejuar ata të zbrazin mbetjet e tyre përpara ose në kohën e ardhjes së mjetit të grumbullimit. Kështu ajo ka ulur mbetjet që zbrazen në mënyrë të pakontrolluar përreth pikave të zbrazjes.

Banorët, duke ditur kohën e grumbullimit, kanë përgatitur mbetjet e tyre dhe dalin jashtë për ti zbrazur ato kur dëgjojnë muzikën e mjetit të grumbullimit.

Në PP2, kishte për qëllim përmirësimin e ndërgjegjësimit të qytetarëve për reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve, për të reduktuar sasinë e mbetjeve që do të grumbullohet dhe do çohet në landfill, dhe për të ndihmuar përmirësimin e gjendjes së mbetjeve të shpërhapura. Për këto qëllime, bashkia ofroi shërbimin "Grumbullimi me zile" një herë në javë veçanërisht për të ricikluesshmet. Një mjet grumbullimi u përgatit për të luajtur një melodi të përzgjedhur për këtë lloj grumbullimi kur vazhdonin nëpër zonat e banuara, dhe banorët pritej të zbraznin të ricikluesshmet e synuara (PET, plastikë e fortë dhe e butë, hekur/kanaçe alumini, dhe sende të përbëra nga hekura të tjerë) pasi mjeti vjen në afërsi të shtëpive të tyre.

Kjo u zbatua në të gjithë zonën e NjA Cërrik. Një fletëpalosje tjetër që shpjegonte një ditë dhe kohë për grumbullimin dhe rregullat u shpërnda në çdo shtëpi nga ana e stafit të bashkisë dhe ndihmësve të tyre të punësuar përkohësisht.

Në lagjen 3 ku PP1 është zbatuar, më shumë banorë ishin bashkëpunues për PP2 dhe zbraznin të ricikluesshmet e tyre në ditën e caktuar në mjetin e grumbullimit i cili vjen nga e njëjta rrugë si në PP1, se në zonat e tjera, ku vetëm pak familjet të kufizuara kujdeseshin për të përdorur shërbimin.

Sipas disa raporteve të shkurtër nga ana e qytetarëve që jetojnë në zonat urbane, ku ekzistojnë shumë pallate, ata gjetën shërbimin të vështirë për ta kapur pasi ai nuk u ndal në një vend për një kohë të gjatë, të mjaftueshme për banorët që do të vijnë dhe zbrazin pas dëgjimit të melodisë nga mjeti. Në një zonë rurale ku mbizotërojnë shtëpi individuale banimi, e ngjashme me Lagjen 3, mungesa e grumbullimit derë më derë të mbetjeve bashkiake duket të ketë qenë një faktor në pengimin e angazhimit të banorëve në grumbullimin e ndarë të të ricikluesshmeve.

The collection worker collects the recyclables separately discharged at a house gate on the day designated for recyclable collection.

Bazuar në këto rezultate, Projektet kanë riformuluar PP2. Për zonën rurale, në Lagjen 2, grumbullimi derë më derë për mbetjet bashkiake gjithashtu është zbatuar. Gjithashtu, bashkia ka marrë masa për të optimizuar koston. Ata e ofrojnë këtë shërbim grumbullimi për mbetjet bashkiake në të njëjtën ditë dhe me të njëjtin mjet si grumbullimi i të ricikluesshmeve në dy Lagje (2 dhe 3). Mjeti është i pajisur tani me disa kosha në kazanin e tij, dhe të ricikluesshmet që zbrazen nga banorët grumbullohen në këto kosha.

Projekti do të kryejë rishikimin e vëzhgimit për të nxjerrë mësimet e marra nga këto projekte pilote në mënyrë që ato të përfshihen në draft Udhërrëfyesin 3R përfundimtar për të bërë sugjerime për zbatim në bashkitë e tjera si dhe për vazhdimin e aktiviteteve 3R në Bashkinë Cërrik.

Projekte Pilot në Bashkinë Tiranë

Në NjA Tiranë, zona e Laprakës është përzgjedhur si një zonë e synuar për të zbatuar aktivitetin e riciklimit në shkolla. Pesë shkolla publike në zonë, përkatësisht 28 Nëntori, Ahmet Gashi, Skënder Luarasi, dhe Gjergj Fishta, shkolla 9-vjeçare dhe Aleks Buda, Shkollë e Mesme, janë përfshirë që nga Shkurti 2016 dhe nxënësit e tyre janë duke i zbrazur të ndara shishet PET, shishet e vogla të qelqit dhe kanaçet e aluminit & hekurit.

Nxënësit janë të inkurajuar të zbrazin të ricikluesshmet e synuara në kosha të vegjël riciklimi të vendosur në çdo kat të shkollës së tyre dhe në

oborrin e shkollës, dhe përfundimisht i grumbullojnë ato në një thes të madh i ndarë për secilën shkollë. Pasi thesi mbushet, ricikluesi kontaktohet për grumbullimin.

Një skelet për të mbajtur thesin e madh është ndarë për secilën shkollë. Këtu tregohet një nxënëse duke zbrazur të ricikluesshmet e grumbulluara në klasën e saj, në thesin e shkollës në shkollën 28 Nëntori.

Ricikluesi, në oborrin e tyre, klasifikon të ricikluesshmer e pranuara nga çdo shkollë sipas llojit, duke hequr sendet të cilat nuk mund të shiten në treg, dhe peshon të ricikluesshmet që mund të shiten sipas llojit. Lekët e të ricikluesshmeve që shiten i dorëzohen secilës shkollë, të cilat do menaxhohen dhe shfrytëzohen nga secila shkollë për përmirësimin e shkollës së tyre. Një shkollë grumbullon mesatarisht rreth 57 kg për një shitje, që përmban të ricikluesshmet e synuara si dhe disa të ricikluesshme të tjera, dhe vlejnë mesatarisht rreth 1138 lekë. Shumica e tyre janë zbrazur në shkollë nga nxënësit e tyre por disa nga shkollat kanë filluar të inkurajojnë nxënësit të sjellin të ricikluesshme nga shtëpitë e tyre.

Shumica e shkollave kanë dërguar disa nga nxënësit e tyre për inspektim të proçesit të peshimit dhe ata janë familjarizuar me gjërat që duhet të grumbullojnë dhe cilat jo. Kjo ka ndihmuar në reduktimin e jo të ricikluesshmeve të zbrazura në këto kosha.

Nxënësit e shkollës 28 Nëntori duke inspektuar proçesin e peshimit të të ricikluesshmeve.

Në anën tjetër, shkollat zbrazin shumë letër dhe qese plastike siç shihet gjithashtu në shkollat e tjera, por ato nuk janë të synuara aktualisht nga PP pasi ricikluesit në treg merren me materiale të tilla vetëm në sasi të mëdha. Nxënësit janë të vetëdijshëm që këto materiale janë gjithashtu të ricikluesshme në përgjithësi, dhe do të jetë e nevojshme për të gjetur një zgjidhje për vënien e tyre në rrugë për riciklim.

Projekti ka filluar PP1 duke synuar shkollat, me qëllim zgjerimin e fokusit në komunitetin përreth. Në Maj, në fund të vitit shkollor, Projekti zhvilloi një pyetësor për prindërit e nxënësve të shkollave të synuara. Rezultatet tregojnë interes shumë të lartë të tyre për aktivitetin riciklues dhe janë të gatshëm të marrin pjesë në një aktivitet të ngjashëm me të ricikluesshmet e tyre të gjeneruara në nivel familje.

Ndërkohë, përpara pushimeve verore, disa nxënës, përfaqësues të Shkollës së Mesme Aleks Buda vizituan lokale në komunitetin e tyre dhe i shpjeguan aktivitetin e riciklimit në shkolla, duke kërkuar bashkëpunimin e tyre. Pasi viti i ri akademik të fillojë, grupe nxënësish do të vizitojnë disa nga këto lokale për të grumbulluar të ricikluesshmet e tyre.

Nxënësit e Aleks Budës duke i shpjeguar lokaleve në lagjen e shkollës së tyre për aktivitetin e riciklimit dhe duke i kërkuar bashkëpunim.

Trajnimi i Dytë i Homologëve në Japoni

Projekti ftoi katër homologë nga bashkitë e Cërrikut dhe Vaut të Dejës, të cilët po zbatojnë projektin pilot në bashkëpunim me anëtarët e Projektit në Qytetin e Ogakit në Japoni në Maj 2016. Trajnimi zgjati për 10 ditë, duke filluar nga 18 Maji, dhe ata kishin leksione dhe vizita për të vëzhguar dhe mësuar menaxhimin e mbetjeve të ngurta nga një qeveri lokale në Japoni.

Programi i trajnimit përfshinte vizita në inceneratorin e bashkisë dhe pajisjeve të riciklimit (ndarjes), dhe kompanitë private që merren me riciklimin pyjeve, vajrat e përdorur, dhe qelqet, si dhe një strukturë trajtimi të mbetjeve masive e cila drejtohet nga një shoqatë e pjesshme e punëve e bashkive fqinje.

Ata gjithashtu vizituan një grup qytetarësh dhe mësuan përpjekjet e tyre për të bashkëpunuar me bashkinë në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Ata mësuan si funksionon "kompostimi në kuti kartoni" dhe si mund të mirëmbahet, dhe vëzhguan grupet e fermës ku ata kompostojnë mbetjet bujqësore.

Pjesëmarrësit ishin shumë të kënaqur me trajnimin, dhe u impresionuan me trajtimin e mbetjeve i cili lë vetëm hirin për tu depozituar në landfill. Ata ishin gjithashtu të befasuar kur mësuan se plani i MBN nga bashkia Ogaki përmend në mënyrë të qartë rolin e qytetarëve në menaxhimin e mbetjeve bashkiake. Duke parë se rruga e tyre për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta në qytetet e tyre është shumë e gjatë, homologët tashmë janë të përfshirë me padurim në diskutimet dhe zbatimin e projekteve pilot me anëtarët e projektit në bashkitë e tyre përkatëse.

Vizitë kortezie Kryetarit të Bashkisë së Ogakit.

Pjesëmarrësit e trajnimit vizituan pajisjet e riciklimit për materialet plastike.

Ata gjithashtu u kënaqën me disa vizita në Nagoja dhe Tokio gjatë një fundjave. Këtu një performues Samurai pozoi sëbashku me ta.

Udhëtim Studimi në Bashkinë Prizren

Në 15 dhe 16 Maj 2016, Projekti vizitoi Bashkinë Prizren në Republikën e Kosovës, ku "Projekti për Ngritjen e Kapaciteteve në Menaxhimin e Mbeturinave drejtë një Shoqërie të Shëndoshë" i zbatuar nga 2011 deri 2014, me pjesëmarrjen e tetë homologëve Shqiptarë për të vëzhguar menaxhimin e mbetjeve të ngurta të tyre aktual.

Homologët e projektit morën pjesë në vizita të ndjekur nga një shpjegim i shkurtër që përshkruante projektin e kaluar dhe statusin aktual të menaxhimit të mbetjeve në Prizren si dhe planit të tyre të MBN, i cili u prezantua nga shefi i seksionit të administrimit të mbetjeve të ngurta të bashkisë Prizren. Vizitat përfshinin familjet që praktikonin kompostimin në shtëpi duke përdorur kompostorët e ofruar nga bashkia dhe kompostimin e mbetjeve bujqësore në kopshtin e tyre, një zonë të gjelbër bashkangjitur një pallati, ku banorët kishin "adaptuar" zonën si fëmijën e tyre dhe kryenin mirëmbajtjen e përditshme me pajisje të mirëmbajtjes të ofruara nga bashkia. Ata gjithashtu vizituan një fshat që gjendet në periferinë malore të Prizrenit, ku bashkia kryen shërbimin e grumbullimit derë më derë me zile një herë në javë, njësoj siç e bëjnë në zonën e qytetit. Pjesëmarrësit gjetën program të dobishëm dhe mbetën të mahnitur me raportin e lartë të pagesave të "taksës së mbetjeve" (4.5 euro për muaj, dhe më shumë se 80% e familjeve paguajnë siç duhet). Ata gjithashtu u mahnitën me prezantimin e përmbledhjes së aktiviteteve mjedisore në shkolla të zbatuara sipas udhëzimeve të ngushta nga stafi i bashkisë

Duke marrë shpjegim në lidhje me sistemin e tyre të monitorimit për mbledhjen e taksës së mbetjeve (Dita 1)

Megjithatë, në aspektin e aktiviteteve të kompostimit, edhe pse homologët vlerësuan shumë përpjekjet e përdoruesve dhe zyrtarëve të bashkisë, shumica e përgjigjeve ishin "jo për Shqipëri". Të dy shembujt kishin kopsht relativisht të madh ose fusha bujqësore, e cila mund të jetë një arsye për këtë përgjigje, por shumë homologë treguan "diferencën në mentalitetin e tyre". Homologët gjithashtu dëshironin të vizitonin landfillin, i cili menaxhohet nga një institucion i veçantë shtetëror dhe nuk ishin përfshirë në program këtë herë.

Përveç rezultateve të tilla, vizita dha një mundësi të mirë për të krijuar një atmosferë për shkëmbime të ngushta të ideve mes homologëve të projektit

A.5 Nr. 4

PROJEKTI MBËSHTETJE PËR MINIMIZIMIN E MBETJEVE DHE PROMOVIMIN E 3R-VE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Buletini Nr.4 Shkurt 2017

MINISTRIA E MJEDISIT

Projekti Mbështetje për Minimizimin e Mbetjeve dhe Promovimin e 3R-ve në Republikën e Shqipërisë ("Projekti") *ka përfunduar zbatimin e projekteve të tyre pilote në tre bashki, përkatësisht në Bashkinë Vau i Dejës, Cërrik dhe Tiranë. Bazuar në gjetjet e nxjerra përmes këtyre projekteve pilote, Projekti tani është në proces të përfundimit të Udhërrëfyesit 3R, i cili do adaptohet nga Ministria e Mjedisit. Kjo çështje përmbledh gjetjet nga PP, dhe gjithashtu raporton për workshop-et e Plan Veprimit 3R dhe ndjekja e vizitave të kryera në 40 bashkitë e synuara në 7 qarqe nga Tetori deri në Dhjetor 2016.*

Projekt Pilot në Bashkinë Cërrik: Zbatim i suksesshëm i grumbullimit derë më derë për tranzicion të qetë në grumbullim të ndarë të të ricikluesshmeve.

Bashkia Cërrik në bashkëpunim me Projektin ka zbatuar dy projekte pilote: 1) Përmirësimi i zbrazjes dhe grumbullimit të mbetjeve bashkiake në zonën rurale; dhe 2) Grumbullimi i ndarë i të ricikluesshmeve.

Projekti Pilot 1 filloi me prishjen e pikave të zbrazjes prej betoni dhe kaloi në grumbullimin derë më derë me një kamion që vinte në orar duke luajtur një melodi simbolike, *Moj bubrrec*..

Shumica e banorëve që jetojnë përgjatë rrugëve të ngushta ku kontejnerët bashkiakë nuk mund të vendosen dhe kompaktori i madh nuk mund të futet, e vlerësojnë këtë sistem të ri dhe janë shumë bashkëpunues. Megjithatë, për familjet që jetojnë në rrugë më të gjera dhe të arritshme, mund të shërbehet më mirë me një sistem me kontejnerë bashkiakë. Ky projekt pilot sugjeron një bashki për të kërkuar për një kombinim efektiv të grumbullimit derë më derë dhe grumbullimit me kontejnerë bashkiakë sipas kushteve të çdo lagje.

Në Projektin Pilot 2, grumbullimi i ndarë i të ricikluesshmeve u prezantua në zonën urbane si dhe në zonën rurale ku grumbullimi derë më derë kishte filluar në Projektin Pilot 2. Grumbullimi u prezantua në sistemin derë më derë me një tjetër melodi që luhej. Megjithatë, në mjedisin urban ku mbizotërojnë pallatet dhe banorët kanë qasje të lehtë me kontejnerët bashkiakë të vendosur në rrugët afër, nuk e kanë gjetur këtë sistem të preferuar. Në anën tjetër, në zonën e synuar në Projektin Pilot 1 ku banorët u mësuan me zbrazjen në orar të përcaktuar, zbrazja e ndarë e të ricikluesshmeve në sistemin derë më derë ishte lehtësisht i pranueshëm.

Pavarësisht bashkëpunimit në zonën rurale dhe disa familjeve në zonën urbane, sasia e grumbulluar e të ricikluesshmeve përgjatë një periudhë prej tetë muajsh ishte shumë e kufizuar (263.5 kg në total, dhe mesatarisht 1.09 kg/ditë), për shkak të sasisë së kufizuar të prodhuar të "mbetjeve" të tilla në këtë bashki. Në anën tjetër, ia vlen të përmendet që paratë e fituara nga shitja e të ricikluesshmeve të grumbulluara janë përdorur nga bashkia për blerjen e kontejnerëve të rinj.

Si përfundim, nëse nuk është e përfshirë shumë strategjikisht me grumbullimin e mbetjeve të përgjithshme bashkiake, grumbullimi i ndarë i të ricikluesshmeve me metodën derë më derë nuk do të ketë kosto efektive. Për më tepër, metoda derë më derë për grumbullimin e të ricikluesshmeve do të punojë më mirë nëse prezantohet pasi banorët janë mësuar me një sistem të tillë për grumbullimin e mbetjeve të përgjithshme.

Projekt Pilot në Bashkinë Vau i Dejës: Nevoja për promovimin e kompostimit në vend të mbetjeve të gjelbra

Në Vaun e Dejës, projekti pilot u zbatua në tre faza: 1) për të siguruar një shërbim të përshtatshëm të grumbullimit të mbetjeve nga bashkia; 2) për të vendosur një sistem të përshtatshëm të zbrazjes së

mbetjeve të pranueshëm nga banorët; dhe 3) për të vendosur një metodë të përshtatshme për pakësimin e mbetjeve.

Pas vendosjes së orarit javor për grumbullim në të gjithë zonën e njësisë administrative Bushat gjatë fazës 1, bashkia dhe ekipi i projektit arritën në përfundimin se sasia e madhe e mbetjeve bujqësore e zbrazur në tokë përreth kontejnerëve pengonte shumë në efikasitetin e punës së grumbullimit. Prandaj, në fazën e dytë, ata vendosën dy kontejnerë të mëdhenj në nivelin e tokës të dedikuar për mbetjet bujqësore në dy pika grumbullim. Kjo ka pakësuar në mënyrë drastike kohën e kërkuar për të pastruar pikën e grumbullimit nga 40 minuta në 5 minuta. Gjithashtu, u përmirësua ndjeshëm edhe mjedisi përreth kontejnerëve. Tani Bashkia ka vendosur kontejnerë të tillë në dy pika të tjera grumbullimi duke pritur të njëjtin ndikim.

Në Fazën 3, janë kërkuar metoda për të pakësuar sasinë e mbetjeve të gjelbra që zbrazen në sasi të mëdha dhe transportohen në landfill. Bashkia dhe ekipi i Projektit kanë pasur një seri diskutimesh dhe studiuan mundësinë e zbatimit të kompostimit brenda oborrit si dhe jashtë tij. Kompostimi jashtë oborrit i referohet metodës së kompostimit në të cilin mbetjet organike grumbullohen në një impiant në shkallë të madhe ku mbetjet kompostohen. Kjo metodë nuk pakëson sasinë e mbetjeve të gjelbra që do duhet të transportohen nga shërbimi i grumbullimit të mbetjeve, dhe kërkon kosto shtesë për transportimin dhe menaxhimin e impiantit të kompostimit.

Në anën tjetër, kompostimi brenda oborrit, i cili kërkon prodhuesin e mbetjeve për të kryer kompostimin brenda oborrit të tyre, do të pakësojë sasinë e mbetjeve të gjelbra që do të zbrazen dhe transportohen, dhe do të kërkojë më pak kosto nga bashkia.

Në njësinë administrative Bushat, ata kanë parë se momentalisht rreth 30% e familjeve kryejnë kompostim brenda oborrit, ndërkohë që bashkia e ka të vështirë financiarisht për të zbatuar kompostimin jashtë oborrit. Pra, kompostimi brenda oborrit është një metodë e preferuar për pakësimin e mbetjeve të gjelbra për një bashki të ngjashme.

Megjithatë, jo çdo familje ka hapësirën e mjaftueshme për të kryer kompostimin apo ka gatishmërinë për bashkëpunim. Në realitet, shumë pak janë gjetur të gatshëm për kompostimin edhe pse ata prodhojnë mbetje të gjelbra. Në mënyrë që të promovohet gjerësisht kompostimi, do të jetë e nevojshme për të zhvilluar disa studime për të inkurajuar banorët për të kryer kompostimin brenda oborrit, të tilla si reduktimin e taksave apo subvencioni nga qeveria lokale ose qendrore.

Projekt Pilot në Bashkinë Tiranë: Rritjen e efektivitetit të ndërgjegjësimit nëpërmjet përkrahjes në aktivitetit shkollor

Në zonën e Laprakës në Tiranë, pesë shkolla vazhduan punën për grumbullimin e ndarë të të ricikluesshmeve. Secila shkollë ka zhvilluar mënyrën e saj unike të vazhdimit: Shkolla Ahmet Gashi dhe 28 Nëntori zgjeruan grumbullimin e ndarë të të

ricikluesshmeve në familjet e nxënësve.

Shkolla e Mesme Aleks Buda ka një grup të fortë nxënësish, të cilët punojnë me lokalet bashkëpunues të lagjes. Lokalet mbajnë të ricikluesshmet e prodhuara nga biznesi i tyre dhe ja u japin nxënësve të grupit të cilët vizitojnë këto lokale 2-3 herë në javë. Këto tre shkolla i shesin të ricikluesshmet e tyre të grumbulluara tek një riciklues që është kontaktuar nga stafi i monitorimit të Projektit.

Të ricikluesshmet e sjella nga nxënësit e Ahmet Gashit nga shtëpitë e tyre dhe mbledhja në thesin e ofruar nga Projekti.

Shkolla Gjergj Fishta gjithashtu ka një kontribut për grumbullimin e të ricikluesshmeve nga shtëpitë e nxënësve, dhe ata kanë arritur të gjejnë grumbulluesin e tyre në afërsi të shkollës, në oborrin e të cilit grupi mjedisor i nxënësve çon thesin e mbushur me të ricikluesshme.

Edhe pse fitimi nga shitjet për secilën nga këto katër shkolla është shumë i vogël (një mesatare prej 57kg/thes dhe fitojnë rreth 1140 lekë), përvoja aktuale përmes të cilës studentët mund të dëshmojnë "të ricikluesshmet janë burime" ka një ndikim të madh në ndërgjegjësim e nxënësve si dhe të prindërve të tyre.

Në shkollën Skënder Luarasi, ku sasia e të ricikluesshmeve të prodhuara nuk është aq e madhe sa të tjerat, u punua me krijimin e ndërgjegjësimit brenda shkollës si dhe në komunitet duke krijuar materialet e tyre të ndërgjegjësimit duke përmbledhur mësimet e tyre për riciklimin.

Përvoja e Tiranës përmes zbatimit të projektit pilot tregon se programi i ndërgjegjësimit kërkon aktivitet aktual në përfshirjen e nxënësve për të patur ndikim. Një aktivitet i tillë kërkon një monitorim intensiv dhe mbështetje për shkollat. Për më tepër, aktiviteti i qëndrueshëm i riciklimit në nivel shkolle kërkon një cikël të përfunduar të rrjedhës prej grumbullimit të veçantë nga nxënësit në shkollë deri në shitjen tek një riciklues. Pa e përcaktuar se si dhe kujt do i dorëzohen të ricikluesshmet e grumbulluara, ndarja e të ricikluesshmeve nuk mund të kryhet.

Workshop për të mbështetur formulimin e Plan Veprimit 3R nga Qeveritë Lokale

Ekipi i Projektit, në Shtator dhe Tetor, i shoqëruar nga homologët specialistë të Ministrisë së Mjedisit, kryen workshope në shtatë qarqe duke përfshirë Gjirokastrën, Vlorën, Fierin, Beratin, Elbasanin, Shkodrën, dhe Lezhën, në mënyrë që të rritnin kuptimin e procesit për të formuluar Planin e Veprimin 3R në nivelin e pushtetit lokal. Ekipi bëri shpjegimin në detaje, hap pas hapi, të çdo elementi të "Plan Veprimit 3R" dhe ofroi udhëzimet se si duhet plotësuar grumbullimi i të dhënave bazë të cilat shërbejnë si bazë për planifikimin e aktiviteteve të tyre 3R.

Pjesëmarrësit e workshop-it në Qarkun e Fierit duke u ushtruar në procesin e formulimit të rrjedhës së mbetjeve.

Workshop-et u pasuan me telefonata dhe e-maile drejt korrespondentëve në mënyrë që çdo bashki pjesëmarrëse të ketë të dhënat e plotësuara në mënyrë të përshtatshme. Projekti më tej mbështeti bashkitë me vizita individuale dhe udhëzuar një nga një për të përfunduar analizën e gjendjes aktuale financiare dhe fizike të menaxhimit të mbetjeve të tyre të ngurta. Nëpërmjet këtij procesi, njëzet e tetë (28) bashki janë përgatitur për të bërë përzgjedhjen e arsyeshme të aktiviteteve 3R të përshtatshme me situatën e tyre. Harta e mësipërme tregon bashkitë që janë vizituar nga Projekti dhe janë në proces të formulimit të Plan Veprimit 3R.

Projekti do mbështesë këto bashki vazhdimisht për të përfunduar formulimin e Plan Veprimit 3R përmes komunikimit të ngushtë dhe seminarit të fundit që do organizohet në fillim të Marsit.

Vlerësimi Përfundimtar i Projektit i kryer nga Zyra Qendrore e JICA

Nga 15 Janari deri më 26 Janar, 2017, u krye vlerësimi përfundimtar i Projektit nga komisioni vlerësues i përbërë nga një konsulent Japonez i caktuar për vlerësimin nga Zyra Qendrore e JICA, një ekspert Shqiptar në menaxhimin e mbetjeve, si dhe dy zyrtarë nga departamenti i Grupit të Menaxhimit Mjedisor të Zyrës Qendrore të JICA.

Me vizita në të tre bashkitë e projekteve pilot, intervista me homologët e projektit në bashki dhe nivel ministrish, dhe shqyrtimin e dokumenteve të prodhuara deri më tani nga Projekti, ata arritën në përfundimin se Projekti do të arrijë objektivat e tij deri në fund të periudhës së zbatimit të Projektit; Maj 2017.

Ekipi i vlerësimit duke kryer një intervistë në një shkollë e cila bashkëpunoi me projektin pilot në Tiranë

Ekipi i vlerësimit vlerësoi shumë përpjekjet e bëra nga bashkitë e projektit pilot për prodhimin e gjetjeve të vlefshme për formulimin e Udhërrëfyesit 3R.

Në Komitetin e Përbashkët Koordinues i mbajtur në ditën e fundit të misionit të tyre, ekipi i paraqiti rezultatet e tyre anëtarëve të komisionit të Projektit dhe përfundoi vlerësimin me shpresën se ekipi i ekspertëve Japonez të Projektit dhe zyrtarët e tyre homologë të Ministrisë së Mjedisit do të shqyrtojnë tërësisht së bashku draft Udhërrëfyesin 3R që është duke u përgatitur dhe zyrtarët e ministrisë do të njihen me përmbajtjen e tij, në mënyrë që ata të jenë të përgatitur për të mbështetur qeverinë vendore në promovimin e 3R-ve në Shqipëri.

Ekipi i vlerësimit në foto së bashku me anëtarët e Komitetit të Përbashkët Koordinues dhe anëtarët e Projektit

Seminari përfundimtar mbi Udhërrëfyesin 3R dhe Plan Veprimin 3R që do të mbahet në 9 & 10 Mars, 2017

Projekti, me përmbledhjen e veprimtarisë do të organizojë Seminarin mbi Udhërrëfyesin 3R dhe workshop-in përfundimtar për formulimin e Plan Veprimit 3R në 9 dhe 10 Mars, 2017. Draft Udhërrëfyesi 3R pritet të përfundohet deri atëherë në formën e një dokumenti teknik të Ministrisë së Mjedisit, dhe përmbajtja e përfunduar do të prezantohet për pjesëmarrësit.

I njëjti rast do të përdoret për të përfunduar draft Plan Veprimet 3R për bashkitë të cilat po përgatiten nga shumë bashki duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga Projekti. Pjesa thelbësore e përzgjedhjes së aktiviteteve 3R dhe formulimin e planit të tyre të zbatimit do të shpjegohet. Pjesëmarrësit pritet të përfundojnë këtë proces për Planin e Veprimit 3R gjatë seminarit nën drejtimin e ekipit të Projektit.

Të gjitha bashkitë do të ftohen, me udhëzime të veçanta, për të ndjekur seminarin. Të gjithë ata që nuk e kanë pasur mundësinë të marrin pjesë në ndonjë nga workshop-et e mëparshme do të marrin gjithashtu një ftesë dhe janë të mirëpritur të marrin pjesë me një Plan Veprimi 3R para hartimit. Forma e Planit do të jetë në dispozicion nga Projekti, nëse ndonjë nga bashkitë pjesëmarrëse nuk e ka marrë një të tillë akoma.

A.6 Nr. 5

PROJEKTI MBËSHTETJE PËR MINIMIZIMIN E MBETJEVE DHE PROMOVIMIN E 3R-VE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Buletini Nr.5 Maj 2017

Çështja përfundimtare e Buletinit të Projektit do të përmbledhë pikat kryesore në fazën përfundimtare të Projektit.

Udhërrëfyesi 3R, *si një produkt përfundimtar i 3 viteve të* ***Projektit Mbështetje për Minimizimin e Mbetjeve dhe Promovimin e 3R-ve në Republikën e Shqipërisë*** *("Projekti"), tani është përfunduar dhe do të ndahet me të gjithë zyrtarët përkatës së Ministrisë së Mjedisit, Autoritetit Mjedisor, qarqet dhe bashkitë, si një dokument teknik i Ministrisë së Mjedisit në fillim të Majit. Një përmbledhje e Udhërrëfyesit u prezantua me zyrtarët e bashkive, përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve të ngurta (MMN) në të gjithë vendin, në seminarin përfundimtar të mbajtur në Tiranë në datë 9 & 10 Mars 2017. Përveç Udhërrëfyesit, tani janë 26 bashki të cilat kanë draft Planin e tyre të Veprimin 3R. 3 bashki prej tyre patën mundësinë ta mësonin MMN të tanishëm në Japoni në fillim të Prillit.*

Tani në dispozicion "Udhërrëfyesi 3R":

Shqipëria ka vendosur si qëllim të jetë një shtet anëtar i Bashkimit Evropian (BE) dhe politikat e saj mjedisore janë vendosur në përputhje me Direktivat e BE. E ngjashme me MMN, Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve të Shqipërisë (në vazhdim "Strategjia") që ka hyrë në fuqi në 2015, përcakton qëllimin për të pakësuar mbetjet deri në 25% në 2014, 35% në 2016, dhe më pas 55% në 2020. Si pjesë e strategjisë për arritjen e një qëllimi të tillë, vendi ka prioritet promovimin e 3R-ve (Reduktim, Ripërdorim, Riciklim) të mbetjeve të ngurta bashkiake. Në anën tjetër, bashkitë janë mandatuar për të ofruar dhe menaxhuar shërbimet e duhura të menaxhimit të mbetjeve të ngurta për qytetarët e tyre. Kjo do të thotë që plani i menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkiake duhet të përfshijë planin e tyre të promovimit të 3R-ve. Për të ofruar udhëzime për bashkitë për këtë proces planifikimi, "Udhërrëfyesi 3R" është zhvilluar në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve si dhe me Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve.

Faqja e parë e "Udhërrëfyesit 3R"

Objektivat e "Udhërrëfyesit 3R" janë vendosur si më poshtë: 1) Kur NjQV-ja zbaton aktivitetet 3R, Plan Veprimi 3R zhvillohet në përputhje me Udhërrëfyesin 3R. Nëpërmjet këtij procesi, Udhërrëfyesi 3R gjithashtu mbështet NjQV-në për të zhvilluar Planin e Menaxhimit të Mbetjeve; dhe 2) Udhërrëfyesi 3R mbështet një NjQV të zbatojë aktivitetet 3R. Nëpërmjet këtij procesi, Udhërrëfyesi 3R mbështet realizimin e aktiviteteve që synojnë menaxhimin të mbetjeve në planin e tyre.

Udhërrëfyesi përbëhet nga 3 komponentët e mëposhtëm të cilat përfshijnë temat si më poshtë:

1. Politika Kombëtare 3R
   - Gjendja e tanishme dhe problemet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe problemet në nivel kombëtar.
   - Politika Bazë Kombëtare për 3R
     - Krijimi i Kuadrit të Planifikimit
     - Objektivat e ardhshëm
     - Strategjia për promovimin 3R
2. Përzgjedhja e Aktiviteteve 3R
   - Ekzaminimi i aktiviteteve 3R të realizueshme në kontekstin Shqiptar.
   - Pikëpamje dhe çështje që duhen marrë parasysh për zbatimin e aktiviteteve të përzgjedhura.
3. Zbatimi i Aktiviteteve 3R nga NjQV-të
   - Hartimi i Plan Veprimit 3R
     - Kuptimi i kushteve dhe problemeve të tanishme te MMN në NjQV
     - Përzgjedhja e aktiviteteve 3R
     - Konfirmimi i Figurave të Planifikimit 3R
     - Zhvillimi i Rrymës së Mbetjeve në të ardhmen
     - Zhvillimi i Planit të Zbatimit të aktiviteteve 3R
   - Zbatimi dhe Vlerësimi i aktiviteteve 3R

Kopjet e printuar në madhësinë A4 të "Udhërrëfyesit 3R" u dorëzuan në MM nga Ekipi i Ekspertëve Japonez (EEJ) të Projektit në fillim të Majit dhe do i postohen secilës bashki. Do të vijë me një CD që përmban formulën për të mbështetur zhvillimin e "rrymës së mbetjeve" të tanishme dhe në të ardhmen për secilën bashki.

Seminar për prezantimin e draft Udhërrëfyesit 3R të përfunduar me Seminarin e raportimit të rezultateve të Projekteve Pilot 3R:

Projekti mbajti seminarin përfundimtar me titull "Seminar për prezantimin e draft Udhërrëfyesit 3R të përfunduar me Seminarin e raportimit të rezultateve të Projekteve Pilot 3R" në datë 9 dhe 10 Mars, 2017. Dita e parë e seminarit u organizua në Hotel Tirana Internacional, dhe dita e dytë e seminarit u zhvillua në Bashkinë Cërrik.

Objektivat e seminarit ishin, 1) Raportimi i

rezultateve përfundimtare të Projektit Pilot 3R të kryer nga Projekti, 2) Prezantimi përfundimtar i draft Udhërrëfyesit 3R, 3) Thellimi i të kuptuarit të Plan Veprimit 3R dhe formulimi i tij, dhe 4) Ndarja e eksperiencës dhe mësimeve të Projektit Pilot duke vizituar Bashkinë Cërrik.

Seminari përfundimtar mblodhi numrin më të madh të pjesëmarrësve nga bashkitë në të gjithë vendin në tre vite të periudhës së zbatimit të Projektit; 56 persona nga 40 bashki, sëbashku me përfaqësues nga 10 qarqe, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, dhe Ministria e Zhvillimit Urban.

Një total prej 86 pjesëmarrësish mbushën vendin në Sallën Consortium, Hotel Tirana Internacional në Tiranë, në ditën e parë të seminarit.

Filloi me fjalën e hapjes nga Ministria e Mjedisit, e ndjekur nga tre prezantimet rreth rezultatit të projekteve pilot të zbatuara në bashkitë Vau i Dejës, Cërrik, dhe Tiranë (Detajet e rezultateve janë prezantuar në numrin e mëparshëm të Buletinit).

Bashkia Vau i Dejës prezantoi rezultatet e PP mbi ndarjen e mbetjeve bujqësore dhe domosdoshmërinë e kompostimit brenda oborrit.

Bashkia Cërrik prezantoi rezultatet e PP mbi grumbullimin derë më derë dhe grumbullimin e ndarë të ricikluesshmeve.

Bashkia Tiranë prezantoi rezultatet e PP mbi grumbullimin e ndarë të ricikluesshmeve.

Zyrtari i MM dhe EEJ lehtësuan sesionin e shumë aktiv të Q & A gjatë seminarit.

Ministria gjithashtu prezantoi përmbajtjen e përmbledhur të "Udhërrëfyesit 3R". Seminari gjithashtu shërbeu si një mundësi për zyrtarët e bashkive për të bërë pyetjet e tyre djegëse në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, duke përfshirë trajtimin e mbetjeve industriale, dhe vendosjen e tarifave bashkiake për mbetjet, dhe tema të tjera në lidhje me mbetjet. Përfaqësuesit e MM dhe MTI iu përgjigjën sinqerisht këtyre pyetjeve.

Një tjetër temë e rëndësishme e ditës ishte zhvillimi i Planeve të Veprimit 3R të Bashkive. Plan Veprimi 3R mund të zhvillohet duke ndjekur udhëzimet e ofruara në Udhërrëfyesin 3R, por Projekti kishte bërë përpjekjet e tij për të formuar një kuptim më konkret midis zyrtarëve të bashkive, përmes workshop-eve në nivel qarku dhe vizitave individuale në tre muajt e fundit. Si rezultat i kësaj përpjekje, në kohën e seminarit përfundimtar, 24 bashki kishin hartuar Planin e tyre të Veprimit 3R. Përveç tyre, dy bashki të tjera kishin bërë përpjekjet e tyre për të zhvilluar planet nga seminari. Gjashtë bashki të tjera kishin plotësuar analizat e tyre për gjendjen e tanishme të MMN në bashki. Këto Plane Veprimi 3R bashkiake iu dorëzuan bashkive përkatëse gjatë seminarit, pasi EEJ vërtetoi qëndrueshmërinë dhe realizueshmërinë e planeve të tyre.

Draft Plan Veprimi 3R iu shpërnda 30 bashkive.

Bashkia Ura Vajgurore dhe Konispol prezantuan draft Plan Veprimet 3R të plotësuara si shembuj të mirë.

Trajnimi i 3-të i Homologëve i zhvilluar në Qytetin Ogaki në Japoni

Trajnimi i tretë i homologëve u krye nga data 2 deri në 12 Prill 2017 me bashkëpunimin e Qytetit Ogaki në Prefekturën Gifu në Japoni, ku ishin kryer edhe dy trajnimet e mëparshme të homologëve. Këtë vit, morën pjesë tre zyrtarë të angazhuar në MMN në Bashkinë Përmet, Konispol dhe Ura Vajgurore. Ata qëndruan në qendrën e JICA Chubu në qytetin e Nagoya, 44km larg nga Ogaki, ndërsa pjesa më e madhe e programit u zhvillua në qytetin Ogaki. Qyteti Ogaki ndodhet në pjesën qendrore të Japonisë dhe ka një popullsi prej 160,000 banorë, në një zonë përafërsisht 200 kilometra katrorë.

Programi përbëhej nga një seri leksionesh dhe

vizitash në terren. Ishin tre leksione: "MMN në Japoni", "Menaxhimi i mbetjeve industriale në Prefekturën Gifu" dhe "MMN në qytetin Ogaki", të cilat mbuluan një gamë të gjerë temash mbi MMN dhe 3R-ve në Japoni, të tilla si rolet e çdo sektori publik (qeveria qendrore, prefektura dhe bashkia), sektori privat (ndërmarrje biznesi) dhe qytetarë në MMN; historia e MMN; dhe korniza ligjore në lidhje me MMN dhe 3R.

Vizitë kortesie tek Kryetari Bashkisë së Ogakit. Tre herë trajnimet e Projektit janë kryer në bashkëpunim me qytetin Ogaki.

Gjatë vizitave në terren, të trajnuarit mësuan punën praktike të MMN dhe 3R-ve të stafit bashkiak në qytetin Ogaki duke vëzhguar grumbullimin e mbetjeve familjare dhe duke vizituar impiante të trajtimit të ndërmjetëm (impiante incenerimi, impiante ndarje dhe ngjeshje për të ricikluesshmet, impiante trajtimi për mbetjet masive), dy lloje të venddepozitimeve përfundimtare (për hirin e incenerimit, dhe për mbetjet inerte) dhe disa impiante në lidhje me MMN ose 3R (spitalin bashkiak, fabrikën e drurit pelet, impiantin e riciklimit të vajit të përdorur) në Ogaki. Ata gjithashtu vizituan impiantet e riciklimit të drejtuara nga sektori privat që merren me plastika dhe shishe qelqi dhe gjithashtu vëzhguan dy lloje të ndryshme kompostimi, kompostimi i bajgës së lopë i praktikuar nga fermerët dhe kompostimi i kutive të kartonit nga grup qytetarësh.

Qendra e Riciklimit Ogaki. Këtu, të ricikluesshmet e grumbulluara nga familjet ndahen sipas materialeve manualisht. Pastaj, të ricikluesshmet paketohen nga një kompresor.

Përmes trajnimit, të trajnuarit thelluan të kuptuarit se si MMN dhe aktiviteti 3R janë kryer në Japoni, të dyja teorikisht dhe praktikisht.

Ka pasur shumë mundësi për të shkëmbyer ide midis Japonisë dhe Shqipërisë në secilin program. Të trajnuarit ishin të impresionuar jo vetëm duke parë teknologjinë ose sistemin e aplikuar në impiante por edhe me ndërgjegjësimin e lartë të qytetarëve ndaj ruajtjes së mjedisit që mundëson krijimin e mjedisit të pastër.

Gjatë sesionit përfundimtar të kryer në ditën e fundit të trajnimit në Qendrën e JICA Chubu, të trajnuarit komentuan "Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimi mjedisor është aktiviteti më i rëndësishëm për ne dhe i realizueshëm nga bashkitë tona." Të trajnuarit ishin të kënaqur që morën pjesë në trajnim dhe vlerësuan thellësisht mikpritjen e popullit të Qytetit Ogaki dhe stafit të përfshirë në trajnim. Pritet që të trajnuarit të shfrytëzojnë përvojën e tyre në Japoni për përmirësimin e MMN dhe promovimin e aktivitetit 3R në Shqipëri.

Puna e grumbullimit të mbetjeve familjare. Banorët zbrazin mbetjet të ndara sipas rregullave në pikat e caktuara të zbrazjes dhe grumbullimi kryhet në ditën e programuar.

Takimi përfundimtar i Komitetit të Përbashkët Koordinues i mbajtur më 25 Prill

Takimi i 6, dhe përfundimtar, i Komitetit të Përbashkët Koordinues (KPK) i Projektit u mbajt në sallën e konferencës në Ministrinë e Mjedisit në 25 Prill 2017, me pjesëmarrjen e anëtarëve të KPK duke përfshirë përfaqësuesit nga Ministria e Mjedisit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Bashkia Tiranë, Bashkia Cërrik, Bashkia Vau i Dejës, Qarku Tiranë, si dhe Zyra e JICA në Ballkan.

Ekipi i Ekspertëve Japonez (EEJ) të Projektit raportuan rezultatet e seminarit përfundimtar të mbajtur në datë 9 dhe 10 Mars dhe trajnimit të 3-të të homologëve në Japoni të mbajtur në fillim të Prillit. EEJ gjithashtu prezantoi draft raportin përfundimtar të Projektit për anëtarët e KPK për komentet dhe

marrëveshjet e tyre. Raporti përfundimtar përfshin përmbledhjen e aktiviteteve tre vjeçare të projekteve.

Anëtarët e KPK vlerësuan përmbushjen e Projektit, sidomos përfundimin e Udhërrëfyesit 3R për Ministrinë e Mjedisit, dhe mbështetjen e EEJ për më shumë se 30 bashki në hartimin e Planit të tyre të Veprimit 3R.

Siç Z. Ryohei Anzai, përfaqësues i Zyrës së JICA në Ballkan, theksoi në fjalën e tij përmbyllëse, në vazhdim pritet që Ministria e Mjedisit të ketë "pronësinë në promovimin e mëtejshëm të 3R-ve në Shqipëri në bashkëpunim të ngushtë me qeveritë vendore dhe energjia e projektit të shfrytëzohet në një mënyrë që të vazhdojë të nxjerrë në pah përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri."

Anëtarët e KPK të mbledhur për takimin e fundit në 25 Prill, 2017.

Mesazh Përmbyllës nga Drejtori i Projektit

~ Prof. Pëllumb Abeshi, Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Mjedisore, Ministria e Mjedisit

Prof. Abeshi në kohën e firmosjes së procesverbalit të KPK5.

Ministria e Mjedisit vlerëson maksimalisht kontributin e dhënë nga qeveria Japoneze dhe programi JICA në kuadër të projektit 3R. Kapacitetet e krijuara dhe forcuara në nivel ministrie dhe të njësive vendore si pjesë e projekteve pilot janë një garanci për të vazhduar në rrugën e menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe në përmbushje të standardeve mjedisore kombëtare.

Galeri Fotosh

~ Pikat kryesore nga Projektet ~

Projekti pati 6 takime të KPK gjatë 3 viteve të kaluara me qëllim lehtësimin e koordinimit ndër-organizativ për ngulitjen e projektit.

EEJ ka kryer vëzhgime bazë të detajuara përpara se të hartonte projektet pilot në secilën bashki.

Bashkia Cërrik prezantoi me sukses grumbullimin derë më derë me sistem zanor.

Vau i Dejës provuan efikasitetin e vendosjes së kontejnerëve për mbetjet bujqësore.

Bashkia Tiranë tregoi aktivitetin e shkollës si një pikë efektive hyrje për komunitetin.

Projekti vizitoi 40 bashki për të ofruar udhëzim dhe mbështetur formulimin e Plan Veprimit 3R.

Zyrtarët homologë nga bashkitë morën pjesë në çdo hap të zbatimit të projektit pilot.

Trajnimi i Homologëve në Bashkinë Ogaki në Gifu, Japoni u zhvillua 3 herë.

Homologët gjithashtu bënë një vizitë në Prizren, Kosovë për të vëzhguar përmirësimin e MMN nëpërmjet bashkëpunimit të JICA.

B Informacioni publik

Informacioni i mëposhtëm u lëshua në çdo faqe interneti për palët e interesuara për ta marrë atë.

B.1 Vëzhgimi Mbarëkombëtar mbi Praktikat e Menaxhimit të Mbetjeve

MOE Web site

http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Projekte/Rezultatet_e_Studimit_Kombetar.pdf

B.2 Buletini

MOE Web site (Only forAlbanian)

No. 1: http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Projekte/Buletini_nr._1.pdf

No. 2: http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Projekte/No.2_Newsletter_Alb.pdf

No. 3: http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Projekte/No.3_Newsletter_ALB_(Final).pdf

No. 4: http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Projekte/No4_Newsletter_AL_(web).pdf

No. 5: http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Projekte/No5_Newsletter_AL.pdf

JICA Web site (English and Alnanian)

https://www.jica.go.jp/project/albania/002/newsletter/index.html